



**01 Nr. 01/24**  
**Rahovec, 18.04.2024**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e katërt (4), e cila do të mbahet më:  
**29 prill 2024 (hënë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

### **REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510057-01643-1, zk - Rahovec;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-01643-1, zk - Rahovec;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës – hapësirën e objektit të QKMF-së për shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës, P-01469-1, zk – Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510069-01505-0, zk - Retijë;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP);
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim të Komunën e Rahovecit;
10. Shqyrtimi i Raportit Financiar, janar – mars 2024;
11. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushë të Madhe;
13. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

---

**Arbër Zenuni**



## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.03.2024**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje të **tretë** të vitit 2024, së bashku me kryetarin, kemi vendosur për këtë rend dite:

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
  2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
  3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024;
  4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e P-02658-0 ZK-Rahovec dhe formimi i parcelës së re në emër të Komunës së Rahovecit;
  5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vjet për organizatat e shoqërisë civile, P-00301-3, zk -Bërnjak;
  6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00301-3, zk -Bërnjak;
  7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
  8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në Rahovec;
  9. Shqyrtimin i Raportit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm;
  10. Shqyrtimi i informatës për menaxhimin e aseteve komunale;
  11. Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;
  12. Shqyrtimi i informatës rreth Programit për Banim për vitin 2023.
- Shtesë:** Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit 01Nr.197/24 i datës 29.02.2024 për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! Ju lutem që të ngritemi në këmbë për të mbajtur një minutë heshtje në nderim të përkujtimit të të rënëve në masakrën e luftës 1999 në Krushë të Madhe, Brestoc, Fortesë, Celinë, Retijë, Opterushë, Pastasellë, Nagac, Hoqë e Vogël...

Të nderuar anëtarë të kuvendit, pas leximit të rendit të ditës e kemi edhe një rekomandim prej KPF-së. Kuvendari Defrim Kafexhiu ka propozuar që në pikën e dytë të rendit të ditës “Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve” të shtohet edhe fjala “diskutime”. Po ashtu edhe kuvendarja Shqipe Kryeziu, propozoi që pika e dytë e rendit të ditës për nga renditja të renditet e fundit në rend dite. Kuvendari Burim Krasniqi ka kërkuar që si material shtesë për kuvend të jetë edhe arsyetimi i bartjes së mjeteve dhe projektet e propozuara. Të gjitha pikat në KPF janë votuar unanimisht për kuvend. Atëherë, para se të kalojmë në votim të rendit të ditës, kuvendari Defrim Kafexhiu nuk qenka prezent. Kuvendari ka kërkuar që pika e dytë e rendit të ditës të emërohet “pyetje, përgjigje dhe diskutime në pyetjet e kuvendarëve”

**Ilir Pallqa:** Atëherë unë po e ripropozoj njejtë si Defrimi, që pika e dytë e rendit të ditës nga pyetje dhe përgjigje të bëhet me diskutim të hapur.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Unë sikur në KPF e mbaj propozimin e njejtë, që pika e dytë të kalojë si pikë e fundit e rendit të ditës. Me arsyetimin që kemi shumë pika të rëndësishme, padyshim që edhe kjo është e rëndësishme. Ne realisht paguhemi dhe e kemi besimin e qytetarëve që duhet të qëndrojmë deri në fund të mbledhjes.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë, media. Të njejtin shqetësim e kam shprehur edhe në KPF. E kuptoj që secili e ka të drejtën e propozimin, por te pjesa e diskutimeve të hapura apo pyetjeve që të jetë në fund, mendoj që është injorim i nivelit të pikes së diskutimit. E dyta, kryesues, praktikat e thonë që shpeshë na bie t'i ndërprejmë seancat për shkak të mungesës së kuorumit dhe absolutisht nuk qëndron ajo që asambleistët do të qëndrojnë deri te pika e fundit e rendit të ditës. Është një orientim që të shuhet mundësia e diskutimit. E falënderoj ekzekutivin sepse gjatë kohës së diskutimeve kemi ballafaqime, mospajtime që është proces normal, por të tentohet të bëhet si pikë e fundit, kjo pikë asnjëherë nuk do ta ketë seriozitetin që e ka. Nëse mendojmë që pikët e tjera që vinë si kërkesa të qytetarëve drejtuar asambleistëve, është qasje e gabuar. Praktikrat në kuvend të Kosovës gjithashtu thonë që kjo është pjesë hyrëse në rend të ditës dhe në momentin që shkon në fund, serioziteti i saj është e barabartë me zero. Më mire ta hiqni krejt, se sa të jetë si pikë e fundit e rendit të ditës. Grupi i LDK-së nuk pajtohet që kjo pike të jetë e fundit dhe nëse ndodh një mbivotim atëherë do ta shqyrtojmë sjelljen tonë dhe prezencën në asamble komunale, është e papranueshme.

**Hasan Përboqi:** Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë kuvendarë, drejtorë, media, qytetarë. Në emër të grupit të asambleistëve të Aleancës, më lejoni t'i paraqes dy qëndrimet tona në lidhje me këto propozime. Sa i përket propozimit në KPF nga asambleisti Defrim Kafexhiu, ne si grup e kemi paraqitur edhe më herët që kuvendarit duhet t'i lejohet edhe pjesa e diskutimeve, por çdo herë duhet iu përmbajtur rregullores së kuvendit sa i përket minutazhës. E përkrahim propozimin që asambleisti ta ketë hapësirën e vet për diskutime. Sa i përket propozimit të kuvendares Shqipe Kryeziu, po ashtu e përkrahim. Si grup i kemi disa arsye. E para dhe më e shëndosha është që para pyetjeve dhe përgjigjeve janë disa pika tjera vendimmarrëse që kanë një rëndësi më të madhe dhe ndikojnë direkt te qytetarët. Të tregohemi pak real, cila është më e rëndësishme: Pyetjet dhe përgjigje apo bartja e mjeteve, apo në në shtator, buxheti? Ne si asambleista të Aleancës kemi qëndruar çdo herë deri në momentin e mbylljes së seancës, ashtu do të vazhdojmë të qëndrojmë edhe kur të levizë kjo pikë. E fundit, kuvendi është arenë e përballjeve dhe e demokracisë ku secili fiton nëse i ka votat. Ne besojmë që kjo pikë duhet të kalojë si e fundit. Rëndësia nuk i ulet asnjëherë dhe nuk ka të bëjë me ndalesën e fjalës së lirë. Një asambleist nëse është i përkushtuar në besimin qytetar, atëherë ai duhet të qëndrojë deri në momentin e fundit të mbylljes së seancës. Kërkojmë gjithashtu që edhe ekzekutivi të qëndrojë deri në fund t'i dëgjojë pyetje dhe t'u përgjigjet atyre.

**Sinan Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Vlerësoj dhe konsideroj që propozimi i Shqipes është i drejtë. Këtu jemi për të nxjerrë vendime. Konsideroj që te pika nr. 2, dikush në shtëpi e bën ndonjë koncept, e lexon këtu dhe ecin nga mbledhja. Besoj që pika që dalin prej KPF-së janë shumë të rëndësishme dhe në fund të seancës mund të parashtrojmë pyetje dhe të komentojmë, si dhe të dalim me një konkluzion të caktuar.

**Sejfullah Sejfullahu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë. E kam një propozim ndryshe: Pyetjet dhe përgjigjet të mbesin në pikën e dytë dhe t'ia shtojmë një fjalë "debat" në fund.

**Ilir Pallqa:** Nëse mbetet pyetje dhe përgjigje kështu siç është, a do të kemi të drejtë të bëjmë diskutime dhe propozime konkrete?

**Rasim Fazliu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, kryetari, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët, mediat, të pranishmit. Që të jemi të sinqertë, propozimi që të thuhet që pika e dytë të vihet më poshtë në fund, vetëvetiu po bëjmë dallime në pika. Mendoj që të gjitha pikat janë të rëndësishme dhe nuk është më pak e rëndësishme ajo pikë që është në fund dhe ajo që është në fillim. Sikur në Oda që ulen burrat, vetëm që duhet të dimë të flasim, sepse si të ulemi në ballë të oxhakut, si në fund është njësoj. Në qoftëse ne jemi konstruktivë si anëtarë të kuvendit bashkë me qeverinë komunale, nuk prish punë a është në vendin e dytë, apo në vendin e fundit. Por, vetëvetiu propozimi në fjalë më duket i papranueshëm dhe nuk është dashur të jetë si propozim, sepse përmes kësaj pike bëhen të gjitha adresimet e qytetarëve, gjithashtu merren përgjigjet nga ekzekutivi. Është mirë që mos të humbim kohë rreth kësaj çështjeje, le të mbetet ashtu siç duhet, me kushtin që të jemi konstruktivë. Nëse lëviz, besoj që më shumë do të humbni pikë, sepse më mirë është të mbetet kështu siç është. Ky është mendimi im.

**Nënkryetari:** Faleminderit! I nderuar kryetar, kryesues, drejtorë, kuvendarë, media. Dua të kyçem në këtë pikë të diskutimit. Kushtimisht pikat janë të parat, të dytat, të tretat, kështu thoshte edhe akademik Esat Stavileci sa kam qenë unë student i tij. Ajo që është më e rëndësishme, ju siguroj që ekzekutivi do të jetë prezent prej fillimit deri në fund, siç ka qenë i pranishëm deri në këtë ditë, 28 mars 2024. Besoj që asnjëherë nuk kanë munguar përgjigjet prej secilit drejtor, prej kryetarit dhe prej meje. Pajtohemi që formulimi i pikës të jetë: “Pyetje, përgjigje dhe diskutime”, mirëpo, gjithashtu kërkojmë prej kryesuesit që ta zbatojë rregulloren (minutazhën) për secilin anëtar të kuvendit. Diskutim të ngjashëm me asamblëistin Rasim Fazliu e kam pasur në vitin 2014, nëse nuk gaboj. Në atë kohë, si Aleancë kemi qenë në opozitë. Si pikë e rendit të ditës, kjo pikë ka qenë e dyta, e kemi bartë të fundit dhe më pas e kemi lëvizë. Në këto institucione jam shumë gjatë dhe e di që kjo pikë e rendit të ditës ka lëvizuar herë e dyta, herë e fundit. Në fund, kuvendarët vendosin përmes votës. Mirë se erdhe Defrim, ne e përkrahim propozimin tënd, mirëpo, renditja vendoset me votë.

**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues i kuvendit, kryetar i komunës, nënkryetar, kolegë anëtarë të kuvendit, drejtorë, media. Në dy mbledhjet e KPF-së të kaluara, kam propozuar që pika e dytë e rendit të ditës të riemërohet në një formë tjetër, ku nuk do të mbetet në hapësirën e kryesuesit cenimi i fjalës së antarëve të kuvendit, apo ndryshimi i formës së diskutimit brenda kuvendit. Kërkesa ime në KPF-në e muajit shkurt ka qenë që kjo pikë e rendit të ditës të ndryshohet duke u shtuar edhe një fjalë, por e kam lënë në vullnet të kryesuesit të kuvendit në konsultim me kryetarin e komunës. Përgjatë një muaji nuk ka pasur ndryshim dhe në seancën e kaluar ka ardhur si pikë e njejtë e rendit të ditës. Në KPF-në e muajit mars, kam propozuar përsëri dhe kësaj radhe kam kërkuar që të vendoset në votim. Përbrenda kuvendit po e shoh një inat, që pas propozimit tim për riemërim të pikës, pason një propozim i Shqipe Kryeziut, e cila propozoi që pika e njejtë të jetë si pikë e fundit e rendit të ditës. Besoj që ky propozim është i ulët. Të jetë propozim prej opozitës është më i arsyeshëm, por të jetë propozim i një anëtari të kuvendit prej pozitës, nuk është i sigurtë dhe është i gabueshëm. Sa më kujtohet mua, përderisa unë kam qenë kryesues, Shqipja është anëtarja e kuvendit që pothuajse asnjëherë nuk ka qëndruar deri në fund të seancave. Kjo është ikje prej përgjegjësisë dhe prej përfaqësimit që na kanë dhënë qytetarët. Vota e determinon këtë punë. Unë ju ftoj që ta mbështetni propozimin tim për riemërimin e kësaj pike të rendit të ditës dhe propozimin e pasinqertë të Shqipe Kryeziut mos ta votoni, si dhe debatet përbrenda kuvendit të vazhdojnë ashtu siç kanë qenë deri tani.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Defrim, ti pyetjen ia bën ekzekutivit dhe ballafaqohesh me ta, jo me asamblenë. A qëndroj deri në fund të seancës, apo jo, është çështje e imja.

**Sejfullah Sejfullahu:** Mendoj që edhe kryetari e dha një propozim të mirë dhe të rehatshëm, ta riemërtojmë ashtu dhe ta bëjmë si në rregullore 3 minuta. Mos na futni në debate me diskutime, sepse këtu nuk jemi duke vendosur për ngrohjen globale.

**Kryesuesi:** Faleminderit Sejfullah! Të nderuar anëtarë, kuvendari Defrim Kafexhiu ka kërkuar që te pika e dytë: “Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve” të shtohet edhe pjesa e diskutimit sipas rregullores, shefat e grupeve 6 minuta, asamblëistët deri në 3 minuta dhe nënkuptohet që mund të ketë edhe tolerime. E kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 21 vota “për”, 4 kundër dhe 1 abstenim, kalon propozimi i kuvendarit Defrim Kafexhiu. Vazhdojmë me propozimin e kuvendares Shqipe Kryeziut që e njëjta pikë të zhvendoset si pikë e fundit në rend dite. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 12 vota “për”, 11 kundër dhe 1 abstenim, kalon propozimi i Shqipe Kryeziut.

**Burim Krasniqi:** Kryesues, e kam thënë edhe në KPF, më vjen keq që duhet ta bëj një sjellje të tillë, por është e papranueshme tendenca që përmes shumicës së votave të ngulfatet diskutimi në asamble komunale. I qëndroj mbrapa qëndrimit tim dhe grupi i asamblëistëve të LDK-së nuk vazhdon me seancë, deri sa nuk trajtohet kjo çështje. Faleminderit shumë dhe punë të mbarë.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit edhe një herë! E thash më herët që ky propozim është shumë i ulët që kjo pikë kaloi si pikë e fundit e rendit të ditës dhe nëse ju dëshironi ta vazhdoni politikën në këtë formë që ta cungoni fjalën e antarëve të kuvendit, duke e ditur të gjithë punën e antarëve të kuvendit që vullneti në fund të seancave gjithmonë ka qenë i vogël për t'i vazhduar diskutimet. Diskutimet më produktive janë bërë në fillim të seancës. Në fund të fundit, këtë pikë mund ta largoni krejt sepse nuk na duhet hiç. Nuk është e hijshme dhe etike prej anës së juaj që si Aleancë, ekzekutiv dhe as prej teje si kryesues.

**Kryesues:** Defrim Kafexhiu, unë jam kryesues i kuvendit dhe çdo propozim të juajin unë e kaloj në votim. Vota është ajo që përcakton.

**Nënkryetari:** Faleminderit kryesues! Vendi për plotësim të dëshirave është diku tjetër dhe jo salla e kuvendit komunal. Shumica vendosë. Vota është legjitime e cila i shtyen proceset, vendimet, rregullore etj... Ti kur je bë kryesues i kuvendit, je bë me votë dhe jo dëshirë. A të pëlqen kjo dhe nëse është pikë e fundit a do të jetë konstruktive, ajo varet nga ju.

**Defrim Kafexhiu:** Nënkyetar, nëse flasim për legjitimitet, nuk e di a keni si ekzekutiv legjitimitet, e leje më si grup i Aleancës në asamble komunale. Nuk jeni legjitim përderisa nuk i keni të gjithë anëtarët në kuvend të zgjedhur prej votës së qytetarëve, i keni vetëm 12 dhe zyrtarisht jeni 15. Nuk mund të llogaritet legjitime. Tjetra, nuk është vend i qejfit kuvendi komunal, por, për juve po, sepse propozimin e anëtares së kuvendit e keni miratuar për arsye që e keni shumicën e votave. Nuk ka këtu qejfe, thjesht e kërkojmë hapësirën për diskutim, e cila po na mohohet. Ju mund ta largoni krejt pikën, na vazhdojmë e bëjmë politikën në një formë tjetër dhe ju në këtë kohë sa ju ka mbetë, vazhdoni si të doni.

**Nënkryetari:** Sa i përket legjitimitetit, nuk i mbaj në mend data sakt, por kështu qysh do të vazhdojë, në veçanti ju edhe për një kohë të gjatë nuk do të jeni në këtë pjesë. Sa i përket asamblesitëve, vota i përcakton. Më pas, sa jeni të fortë që t'i mbani votat aty, ajo është çështje e juaja. Kur një njëri nuk gjen komoditet diku, normal që ndryshon. Njeriu që evulon, ndoshta e ka mirë. Në nivel lokal, mos të flasim për legjitimitet.

**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë! Deri tani e kemi parë që të gjithë e dinë që komuna punon dhe vepron sipas qejfeve të tyre. Sot u vërtetua kjo, gjithashtu u vërtetua që keni frikë të ballafaqoheni me punën e juaj, përderisa nuk e lejon diskutimin në kuvend.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Të dashur kolegë/e asambleista! Si pozita, si opozita duhet t'ia parashtrijmë ekzekutivit pyetjet dhe të diskutojmë me ekzekutivin, jo në mes vete.

**Ilir Pallqa:** Faleminderit kryesues! Kjo është çështje e kuvendit, jo e ekzekutivit, sepse ne po vendosim. Ish kryesuesi foli për legjitimitetin e kuvendit. Sinani e din më mirë që legjitimiteti vjen prej poshtë-lart. Legaliteti vjen prej lart-poshtë. Ju jeni legalë, por jo legjitim.

**Nënkryetari:** Sa i përket ballafaqimeve, në veçanti të kryetarit të komunës, ju e dini sa ka ai "frikë" të ballafaqohet me juve. Për secilën çështje për diskutim, ne jemi të hapur. Ish kryesuesi e përmendi legjitimitetin e ekzekutivit, jo të kuvendit. Si obligim e pata t'i përgjigjem.

**Sinan Kryeziu:** Faleminderit për mundësinë e fjalës! Nëse ka mundësi për vëmendje, sepse kur flas unë kam qejf për vëmendje. Unë e vlerësoj veten, nuk e mbivlerësoj. Po vjen keq që po e them, jo të gjithë, por shumicën këtu i konsideroj si "dele". Duhet ta kemi pak një kod të etikës, ta dëgjojmë dikë kur flet dhe ta respektojmë, pavarësisht që nuk pajtohem me mendimin e x personit. Kur jemi të çështja e bartjes së pikës në fund dhe riformulimin e saj, konsideroj se çdo pikë këtu propozohet ligjërisht nga ekzekutivi (drejtoria e linjës). Ne këtu ballafaqohemi, ata propozojnë dhe më pas vendoset në votim. Asgjë nuk ka të keqe, përkundrazi, propozimin e Defrimit e mbështeta. Kërkoj që të jemi pak më konstruktivë.

**Drilon Mustafa:** Përshëndetje për të gjithë ju që jeni të pranishëm! E kam një pyetje edhe në emër të kolegëve që shkuan, ne që nuk jemi prezent sot, a na del rroga, apo jo?

**Kryesuesi:** Faleminderit! Përderisa nuk kemi kuorum, seanca nuk mund të vazhdojë... Kthehem pas një pauze 20 minutëshe...

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi:** A kemi diskutim për procesverbalin e mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, miratohet procesverbal.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 dhe 2023, në vitin 2024;**

**Afrim Limani:** I nderuar kryesues, nënkryetar, të nderuar asambleistë. Në mbështetje të ligjit të buxhetit të vitit 2024, përkatësisht neni 9, pika 7, e kemi përgatitur një dokument për bartjen e mjeteve nga viti 2022, 2023 në vitin 2024. Shuma e përgjithshme për bartje në total është prej 654.100€. Të gjitha këto mjete janë si rezultat i tejkalimit të të hyrave, me përjashtim të shumës prej 29.346€ që janë mjete të cilat kanë mbetur në kuadër të projekteve dhe të cilat sipas ligjit barten në vitin 2024. Pas një analize të mirë që e kemi bërë, jemi orientuar në tri bartje. E para, i kemi mbuluar disa projekte kapitale të cilat nuk kanë qenë të buxhetuara për vitin 2024 dhe kemi dhënë propozim që këto kontrata të mbyllem me shumën e bartjes së mjeteve, në shumë prej 73.681€. E dyta, jemi orientuar në projekte të reja në shumën 145.000€ dhe pjesa e tretë është në bartjen e mjeteve në kode ekzistuese, në shumën prej

435.418€. Mjetet të cilat barten në kuadër të atyre projekteve që tentojmë t'i mbyllim, janë këto: Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë – 5509€, instalimi i jashtëm i ujit, rrymës dhe kanalizimit në qerdhen Krushë e Madhe – 34.894€, blerja e teknologjisë informative – 9700€ dhe ndërtimi i kioskut në shumën prej 23.578€. Si projekte të reja që na lejon ligji, i kemi propozuar këto projekte: Ndërtimi i urave në terrene fushore, ndërtimi i tezgave për mbajtjen e panairëve – 5000€, rrethimi i oborreve të shkollave – 45.000€, riparimi në 9 shkolla fillore dhe të mesme – 50.000€. Ndërsa, bartja e mjeteve në kuadër të projekteve ekzistuese janë këto: Kemi paraparë rritjen e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, sepse kemi kontrata të cilat paguhen nga kjo kategori – 50.000€, mallra dhe shërbime në administratë – 30.000€, subvencione në shërbime të varrimit – 99.600€. E mira e kësaj pune është që ka ardhur plani kontabël i ri dhe shërbimet e varrimit deri më tani i kemi paguar nga kategoria mallra dhe shërbime, tani sipas planit kontabël të ri, këto duhet të paguhen nga pjesa e subvencionit dhe e kemi shfrytëzuar rastin që me bartje të mjeteve t'i buxhetojmë këto shërbime. Më pastaj: Subvencione në shëndetësi – 400€, ndërtimi i depos në Bërnjak – 80.000€, ndërtimi i muzeut në Krushë të Madhe – 20.000€ dhe ndërtimi i rrugëve në hapësira për biznese dhe turizëm - 150.000€.

**Ilir Pallqa:** Faleminderit kryesues! Nuk lejohet që bartja e mjeteve të ndahet në subvencione.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar drejtorë, kolegë, media, të pranishëm. Te bartja e mjeteve a do të ishte e mundur që të orientohet edhe rruga Hamoc – Celinë, e cila është diskutuar disa herë këtu? Unë personalisht kam pasur disa kërkesa të qytetarëve të Celinës se kjo rrugë nuk është e kalueshme. Nëse ekziston mundësia që këto mjete të barten edhe për këtë rrugë, do të ishte shumë jetike. Nëse edhe këtu nuk keni mundësi, atëherë na tregoni për sa kohë mund të rregullohet. Zgjidhje do të ketë, veçse duhet një vullnet i mirë nga ekzekutivi.

**Afrim Limani:** Ilir, në këtë rast bën dhe besoj që do të bëhet, do ta shohim. E di që ty të kujtohet një diskutim që e kam thënë në vitin e kaluar, qëndroj pas asaj deklaratë. Tani rasti është specifik, sepse ne e kemi pranuar planin kontabël. Bejtë, faleminderit për pyetjen. Ndoshta këtë përgjigje më mirë ta jep Përparimi. Kjo rrugë është shqetësim edhe për ne, por në aspektin e buxhetit kjo rrugë ka kosto. Me mundësi në projektim të buxhetit për vitin 2025 mund ta fusim. Sa e di unë është në kuadër të projektit, vetëm jemi duke pritur për lidhje të kontratës.

**Ilir Pallqa:** Drejtor, kur kemi thënë që vitin e kaluar lejohet, iu kemi referuar ligjit. Unë jam pak i ri, “planin kontabël” nuk po e kuptoj, nëse mund ta shoh si material. Vitin e kaluar gjithashtu është lejuar që bartja e mjeteve bëhet në investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe subvencione, e keni kundërshtuar sepse nuk i keni pasur numrat, tani i keni.

**Afrim Limani:** Ilir, ligji e lejon vetëm në kategorinë paga dhe mëditje nuk kemi të drejtë. Ministria e Financave – Departamenti i Buxhetit nuk e pranon që të ndajmë para në subvencione, sepse në përqindje zvogëlohet kategoria e investimeve kapitale. Qëllimi çdo herë është forcimi i kategorisë së investimeve kapitale. Në këtë rast, ne detyrimisht duhet ta mbulojmë këtë kategori të shërbimit.

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e kuvendit. Sa i përket pyetje së Bejtullahut për rrugën në Hamoc, po është kategori e rrugës fushore (trajtim me zhavorr) dhe është në plan të prokurimit nga Drejtoria e Bujqësisë. Në muajin prill fillojnë procedurat.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi pyetje tjera, këtë pikë e kalojmë në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht votohet kjo pikë e rendit të ditës.

#### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e P-02658-0 ZK-Rahovec dhe formimi i parcelës së re në emër të Komunës së Rahovecit;**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të kuvendit. Në bazë të ligjeve në fuqi, para jush keni propozimin e kryetarit të komunës për një parcelë komunale që gjendet saktësisht te rruga tranzite, zona në Rahovec. Qëllimi i këtij propozimi është se përreth kësaj parcele ka prona private që nuk kanë dalje në tranzit. Ne dëshirojmë ta ndajmë këtë parcelë, ta krijojmë edhe një parcelë tjetër me numër dhe sipërfaqe të re, me pranar të njejtë. Në të ardhmen pronarët e atyre parcelave private ta shfrytëzojnë si të drejt kalimi për të dalur në rrugën tranzite. Pra, parcela me nr. 2658-0 në sipërfaqe prej 2 ha 97 ari e 2m<sup>2</sup> dhe të formohet një parcelë e re prej 7ari e 75m<sup>2</sup>.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A kemi ndonjë diskutim në lidhje me pikën që e prezantoi drejtori?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

## **5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër nga 1-15 vjet për organizatat e shoqërisë civile, P-00301-3 ZK-Bërnjak;**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të kuvendit, media, të pranishëm. Para jush keni propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim për një periudhë afatshkurtër prej 5 vite të shtëpisë së verës në Bërnjak. Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1500m<sup>2</sup>, në shfrytëzim jepen vetëm 486m<sup>2</sup>, duke përfshirë objektin dhe hapësirën e jashtme përballë objektit. Pagesa e qerasë mujore do të jetë 350€ dhe qëllimi i dhënies në shfrytëzim është që ta aktivizojmë këtë objekt, duke e mbushur me aktivitete që promovojnë turizmin në Komunën e Rahovecit.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! Nuk e di a e përmendi drejtori, por bëhet fjalë për shtëpinë e verës. Në KPF e kam dhënë një mendim timin dhe po vazhdoj t'i qëndroj pas. Unë jam kundër që ky objekt të jepet në shfrytëzim në këtë formë. Besoj që më mirë është të qëndrojë si pronë e Drejtorisë së Ekonomisë. Nëse nuk ka, është mirë të bëhet një rregullore për shtëpinë e verës dhe kur organizatat kanë nevojë për shfrytëzimin e hapësirave që ofron ky objekt, në formën se si e sheh të arsyeshme në interes të komunës, drejtoria mund t'a jep në shfrytëzim. Jo të jepet në shfrytëzim për 15 vite dhe jo të shfrytëzohet në mënyrën që ata dëshirojnë ta shfrytëzojnë. Një pyetje tjetër, a ka pasë kërkesë deri më tani? Apo është iniciativë e drejtorisë për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone?

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! Realisht, nuk ka pasur ndonjë kërkesë për marrje në shfrytëzim të shtëpisë së verës. Për mirëmbajtjen higjienike të shtëpisë së verës, për vitin 2023 janë shpenzuar rreth 3800. Për meremetimin e saj në disa pozicione, Komuna e Rahovecit për vitin 2023 ka shpenzuar 18.597€ si investim. Ndërsa, për vitin 2022-2023 përveç festës së vjeljes së rrushit (3 ditë të shtatorit), nuk është mbajtur asnjë aktivitet tjetër që potencialisht do ta promovonte turizmin në Komunën e Rahovecit. Më e keqja është që ky objekt ka qëndruar i mbyllur dhe propozimi ynë është i qartë, të jepet në shfrytëzim.

**Defrim Kafexhiu:** Më herët nuk e ceka, ju e përmendët që Komuna e Rahovecit në vitin 2023 ka shpenzuar 21.000 për rregullimin dhe mirëmbajtjen e atij objekti. Këtë mandat, prej që je Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, a keni marrë ndonjë vendim që do ta ndërronte formën e shfrytëzimit të atij objekti? Kjo çështje e dhënies në shfrytëzim që komuna ka investuar qindra – mijëra € është e gabueshme dhe njëkohësisht paaftësi e Drejtorisë së Ekonomisë. Nuk ka shumë vjet që është ndërtuar ky objekt dhe është dashur që përsëri në vitin 2023 të investohen edhe 18 mijë euro të tjera për meremetimin e tij. Është dashur të jetë një rregullore që të paktën edhe komuna investimin që e bën, t'i rikthehet. Nuk është etike që ajo hapësirë të rrin e mbyllur dhe duke mos e shfrytëzuar asnjë mundësi tjetër të jepet në shfrytëzim për 15 vjet.

**Erhan Morina:** I nderuar z. Defrim Kafexhiu, kërkesa është që ta japim për 5 vite dhe jo për 15. Ky objekt është ndërtuar në vitin 2012 (para 12 viteve). Drejtoria për Ekonomim, Zhvillim dhe Turizëm, aktualisht numëron rreth 5 zyrtarë dhe secili veç e veç e ka elaboratin e vet të punës. Për turizëm është vetëm një zyrtarë që edhe po të donim ne, nuk kemi potencial t'i menajtojmë të gjitha objektet që i kemi. Përveç këtij objekti, ne po mundohemi që edhe objektet tjera t'i japim në shfrytëzim si: Maja e Shkodranit, Kompleksi i Dradishit, ndoshta edhe kullën Toni e Mici.

**Kryetari:** Faleminderit! Kërkoj falje, ishim në një përvjetor për Enver Durakun dhe Shefki Thaqin në kodrën e Dobërdelanit, bashkë me Sefën dhe të tjerët. Sa i përket kësaj pike, në thelb ideja është që sektori publik nuk ka kapacitete për mirëmbajtje, psh: Varrezat e dëshmorëve, martirëve, objektet e trashëgimisë kulturore – historike etj, nuk ka mundësi ndryshe përveç dhënies në shfrytëzim. Në rastin konkret, kërkesa për t'u dhënë në shfrytëzim përmes ankandit "Shtëpia Ndërkombëtare e Verërave" është qëllimi që mos ta lëmë këtë objekt pa e ushtruar funksionin e vetë. Dedikimi i këtij objekti është të ketë aktivitete të gjalla çdo ditë dhe jo 3 ditë në vit. Jemi kujdesur që mos t'ja japim bizneseve, por vetëm shoqërisë civile, sepse ekziston mundësia që bizneset të punojnë me logjikën e biznesit. Objektin e kemi rinovuar vitin e kaluar dhe të kemi aktivitete dinamike në të tilla objekte siç është Shtëpia Ndërkombëtare e Verërave, nuk ka as kryeqyteti Prishtina. Shtëpia duhet të shndërrohet në një shtëpi të verërave që punon në mënyrë dinamike, që pret e përcjellë vizitorë nga brenda dhe jashtë shtetit. Komisioni në kritere do ta përcaktojë përgjegjësinë dhe dedikimin që ka komuna sa herë që ka nevojë për aktivitete. Fatkeqësisht, ju e dini që

ajo shtëpi gjallërohet vetëm kur ka aktivitete të vjeljes së rrushit. Ideja është e shëndoshë që t'i japim mundësi Rahovecit të promovohet më mirë, përmes një objekti që nuk e ka asnjë komunë e Republikës së Kosovës. Në komision le të jetë krejt opozita, ekzekutivi e ka përfaqësuesin e vetë dhe le t'i përcaktojnë qartë kriteret. Shoqëria civile nuk ka përfitime dhe nuk guxojmë t'iu japim bizneseve, sepse menjëherë do ta kërkonin Budrumi i Vjetër, Eko-vera apo Stone Castle, që është shumë legjitime. Mendoj që komuna nuk ka telashe për shfrytëzimin e atij objekti dhe ajo mund të precizohet në një nga nenet dhe kriteret që bëhet nga vet komisioni. Ju ftoj ta votoni dhe t'i japim drejtim këtij objekti jashtëzakonisht të rëndësishëm për komunën tonë.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit kryesues! Mendoj ashtu siç tha kryetari, që duhet të kujdesemi dhe ta japim në shfrytëzim. Konkretisht po flas për vendim dhe propozoj që këtij vendimi t'i shtohet një pikë e veçantë ku thuhet që kushdo prej OJQ-ve që e merrë, të precizohet që mos të kenë të drejtë të zhvillojnë biznes aty. Kam qejf që edhe ky propozim të bashkëngjitet, nesër mund të mos jemi këtu as unë, as kryetari. Me këtë vendim të ndalohet që përfituesit mos të kenë të drejtë të zhvillojnë veprimtari biznese.

**Kryetari:** Po, unë jam dakord për atë që e paraqiti Rasim Fazliu. Realisht kjo është gastronomi, por OJQ-ja që e merrë nuk ka të drejtë që aty të ketë përfitime. OJQ-ja do të kujdeset që t'i mbledh produktet tona dhe t'i promovojë para vizitorëve. Asnjëherë nuk përjashtohet mundësia që të kemi gabime, por jam dakord që veprimtari biznese dhe profitabile nuk është dashur të ketë.

**Rasim Fazliu:** Kryetar, unë jam për atë që në vendim të ceket që kushdo që e merrë prej OJQ-ve mos ta ketë të drejtën e shitblerjes, por vetëm të ekspozimit të produkteve. Të precizohet këtu në një pikë të veçantë.

**Bejtullah Deliu:** Faleminderit kryesues! Sipas elaborimit të kryetarit dhe prezantimit të drejtorit, por edhe teksti që e kemi këtu është i paqartë, apo nuk është i studiuar mirë nga drejtorja përkatëse. Nëse e japim këtë hapësirë dhe themi që është jofitimprurëse, nuk ka komercializëm dhe njëkohësisht këtu e keni cekur 350€ starti. Nëse OJQ-të marrin staf, atëherë do të ketë shpenzime. Cili është vullneti i OJQ-së nëse nuk ka përfitime aty? Ndoshta po degradohet më shumë se sa që është tani aty? Mendoj që në bashkëpunim me DKRS-në dhe Drejtorinë e Bujqësisë, mund të bëhet një plan shumë më i mirë dhe të funksionalizohet shumë më mirë sesa në këtë formë që ju po mendoni. Pra, nëse ju paraprkasht i vendosini kriteret financiare dhe në pjesën e dytë thuani që nuk do të jetë fitimprurëse, atëherë, shpenzimet mujore mendoj që janë së paku 1000€. Ku është qëllimi i OJQ-së? Dyshoj që dikush do të shpreh interesim të krijojë shpenzime sa për reklama.

**Kryetari:** Ne kemi OJQ në Kosovë dhe në Komunën e Rahovecit që aplikojnë në thirrje publike dhe natyrisht ne do t'i subvencionojmë, siç e bëjmë me KF Rahovecin, KH Rahovecin etj... Komisioni ka për detyrë t'i bëjë kriteret. Komisioni është i kuvendit. Kërkoj ndihmën edhe të Mirsadit, sepse është një paqartësi aty. Po, psh: Nëse vjen një turist i huaj dhe aty ka verëra të ndryshme, nuk mund t'ja japim të gjitha "gratis", pra aty mund të caktohet një tarifë dhe të gjitha këto do të jenë pjesë e kontratës. Përfitimi material drejt OJQ-së është i kufizuar me ligj dhe krejt çka mund të bëjë një OJQ është të realizojë programe të caktuara me ndihmën e komunës dhe donatorëve.

**Bejtullah Deliu:** Kryetar, e thash në fillim, nuk është bërë një elaborim i mirëfillt dhe për këtë arsye jemi të paqartë. Drejtori tha që është investuar mbi 18.000€ në vitin 2023, tash po del që komuna do t'i subvencionojë OJQ-të. Ku është tani dallimi? Për çdo muaj t'i paguash minimum 350€, plus mirëmbajtja. Së paku të na sqarohet se çka po votojmë? Nuk e përmenda rastësisht Drejtorinë e Kulturës, që prej saj marrin shumë OJQ subvencione me nga 500-1000€ për aktivitete kulturore dhe gjatë vitit asnjë aktivitet nuk bëhet, shumë pak ose formalisht. Prandaj, kjo shtëpi mund të shfrytëzohet dhe të bëhet funksionale në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, me verëtarë, me gastronomë etj... Është kontradiktë të thuhet që komuna ka investuar në mirëmbajtje dhe gjithashtu themi që do t'i subvencionojmë.

**Kryetari:** Nuk besoj që është kontradiktë, sepse është komponenta "shoqëri civile" është e përcaktuar. Unë thash që subvencione për shoqëri civile ka gjithkrah dhe gjithashtu mund ta shfrytëzojnë të drejtën për aplikim për subvencion për zhvillimin e programit të tyre. Mos ta harrojmë faktin që kur të vendoset për kriteret nga komisioni, gjithashtu



vendoset se çfarë plani vjetor të punës duhet ta ketë një OJQ kur të konkurron. Për moment në atë shtëpi e kemi vetëm një aktivitet, festivalin e vjeljes së rrushit. Duhet të specifikohet se çfarë roli dhe funksioni ka shfrytëzuesi i objektit. 350€ që është aty edhe unë e kam të paqartë, zyra ligjore na shpjegon më vonë. Do të jetë vend i përshtatshëm për shumë takime dhe për shumë aktivitete zyrtare, kulturore – artistike, turistike, panairë etj... Prandaj, është mirë që shoqëria civile ta bartë këtë funksion, sepse komuna nuk ka kapacitete kadrovike. E ftoj Mirsadin të na ndihmojë në këtë pikë për këto 350€.

**Rasim Fazliu:** I qartësuam gjërat mjaft. Mendoj që vendimi duhet të jetë i qartë, të plotësohet edhe me propozimin që e dhash unë dhe pastaj komisioni nuk mund të del jashtë vendimit.

**Mirsad Shala:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit. Të gjitha propozimet që vinë në vendim mund të plotësohen. Duhet të theksojmë që OJQ-të nuk janë profitabile, janë persona juridikë. Mund të bëjmë ndryshime edhe te qëllimi, vetëm te çmimi duhet të dakordohemi. Propozimi i ekzekutivit ka qenë 350€, nëse keni propozime të tjera, atëherë mund të diskutohet. Te qëllimi mund të shtohet ajo që tha baca Rasim.

**Kryesuesi:** Faleminderit Mirsad Shala! Atëherë, të nderuar kuvendarë, në pikën që po diskutohet kuvendari Rasim Fazliu ka kërkuar që vendimit t'i shtohet edhe një nen, që OJQ-ja mos të jetë profitabile dhe mos të lejohen që të zhvillohen veprimtari biznese. E kalojmë në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet propozimi i kuvendarit Rasim Fazliu.

**Rromir Zhuniqi:** Faleminderit kryesues! Përderisa ne po kërkojmë që OJQ-ja që pretendohet që e merr të na promovojë komunën në aspektin turistik dhe ne i vendosim qera 350€. Kërkoj që mos të jetë qëllimi i qerasë, por i projektit më të mirë me të cilin komuna mund të promovohet më shumë. Propozoj që të hiqet krejt, ose të jetë një qera minimale.

**Kryetar:** Jam dakord me Rromirin! Unë propozoj qera 1, 2 apo 3€.

**Kryesuesi:** Tani e kalojmë në votim propozimin e Rromirit, që propozoi të hiqet qeraja dhe të plotësohet në bazë të rregullores. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Kalon propozimi. E kalojmë vendimin në votim me propozimin e Rasimit dhe të Rromirit. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Konstatohet që unanimisht votohet edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kthehemi në sallë pas pauzës 1 orë...

## **6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00301-3, zk -Bërnjak;**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00301-3 – shtëpisë së verës. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, dy prej tyre nga ekzekutivi, dy nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Vazhdojmë me propozimet për komisione!

**Hasan Përboqi:** AAK – nuk kemi propozim!

**Ilir Pallqa:** LVV – ne propozojmë Defrim Kafexhiun!

**Sejfullah Sejfullahu:** PDK – nuk kemi propozim!

**Kryesuesi:** LDK-ja nuk është fare në sallë dhe na duhet edhe një propozim.

**Bejtullah Deliu:** Pasiqë është krijuar kjo situatë, ne propozojmë Sejfullah Sejfullahun.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Atëherë komisioni nga kuvendit është Defrim Kafexhiu dhe Sejfullah Sejfullahu, 2 anëtarë do të jenë nga ekzekutivi dhe 1 nga sektori joqeveritar. E kalojmë në votim, kush është “për”?... Kundër?... Konstatohet që unanimisht votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

## **7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;**

**Nënkryetari:** Faleminderit kryesues! Para vetes e keni vendimin, ne e kemi pasur edhe më herët këtë vendim dhe ju kemi njoftuar që kodi është ndërruar, tani nuk e kemi prej mallrave dhe shërbimeve, por prej subvencioneve. Në hyrje e keni të paraparë për kushtet, specifikimet, kriteret dhe procedurat të ndarjes së subvencioneve. Jemi të vetëdijshëm që kryetari i komunës ka të drejtë që deri në 1000€ t'i ndajë për raste të ndryshme, më shumë se 1000€ kërkohet vendim nga kuvendi komunal. Kërkojmë votën tuaj që ta autorizojmë kryetarin e komunës që bashkëpunimi me bashkësinë islame të vazhdojë, apo nëse janë të interesuara edhe bashkësitë tjera fetare. Shuma për secilin rast përsëri do të jetë 220€.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar Iska. Nëse nuk keni ndonjë gjë tjetër, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e shtatë.

## **8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, anëtarë të kuvendit. Jemi obliguar që t'ju sjellim materialin fizikisht për caktimin e lokacionit sot para seancës, sepse është një afat atje në moment kur parcelat ndahen, për publikim është afati 5 ditë. Pastaj është deklarata e faljes, 5 ditëshi tjetër për nxjerrjen e certifikatës. Ju falënderoj edhe sot edhe për raste të tjera kur nuk kemi arritur t'ju sjellim materialin me kohë. Jam shumë i nderuar, që pas një pune të jashtëzakonshme të kryetarit të komunës, bashkë me drejtorët e drejtorive, posaçërisht të kulturës, urbanizmit, të asambleistëve, të pronarit që ka pasur një vullnet të mirë, sot jemi para një vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit të futbollit në Rahovec. Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Bërnjak, prona është në emër të kompanisë “Stone Castle” me pronar Rustem Gecaj, i cili me vullnet të plotë dhe të lirë, prej pjesës së parcelës me nr. 231-6 që është më shumë se 3.5 ha dhe parcela pas zbatimit të deklaratës për falje do t'i kalojë komunës dhe do ta merr nr. 231-8 me sipërfaqe 3.5 ha.

**Ilir Pallqa:** Drejtor, te rruga kryesore, a keni arritur ndonjë mirëkuptim? Stadiumi i bie të ndërtohet në anën e djathtë!

**Afrim Oruqi:** Kjo parcelë me sipërfaqe të theksuar me ngjyrë të gjelbërt, sipas PZhK-së është e destinuar për zonë për stadium. Sipas këtij planifikimi edhe vetë pronari ka paraparë rrugë (qasje) në drejtim të këtyre parcelave. Kjo parcelë do të kufizohet edhe me dy rrugë të tjera. Do të realizohet qasja më e mirë e mundshme për stadium dhe për elementet tjera që kanë të bëjnë me këtë planifikim.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! Në bazë të këtij vendimi bëhet falja e pronës, apo falja është bërë? Sa do të zgjas kjo procedure? Për çështje të rrugës, a përfshihet në vendimin për falje? Apo vetëm pronari me vullnet të mire do ta lë për shfrytëzim?

**Afrim Oruqi:** Procedura e faljes ka filluar, jemi në proces. Procedura i kap tre sektorë: ndarja, falja dhe zotimi i kuvendit të komunës për caktim të lokacionit. Pastaj bashkë me pronarin, i cili ka shpreh dëshirë t'ia falë komunës këto 3.5 ha nuk besoj që do të kemi telashe për rrugë.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, e kalojmë në votim këtë pikë! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikë shtesë.

## **9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit 01Nr.197/24 i datës 29.02.2024 për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit;**

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, asambleistë. Para jush keni vendimin për shfuqizimin e vendimit 01Nr.197/24 i datës 29.02.2024 për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit. Arsyeja pse ka ardhur ky shfuqizim është sepse vendimi ka shkuar në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ne kemi qenë në koordinim të plotë me agjencionin. Pas kësaj, agjencioni ka filluar me matjet në terren. 50% e asaj që iu kemi dërguar është larguar, me arsye që në atë 100m që duhet të emërohen rrugët nuk ka pasur dendësi të shtëpive. Në këtë seancë kërkoj shfuqizimin e këtij vendimi. Ndërsa,

në seancën e prillit lista do të jetë e përmirësuar, me të njëjtën listë të emrave të pranuar prej Agjencionit të Sistemit të Adresave.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Nëse nuk kemi diskutime, e kalojmë në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

#### **10. Shqyrtimin i Raportit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm;**

**Mirsad Shala:** Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, asambleistë. Para jush e keni raportin vjetor të punës të Komitetit të Auditimit për vitin 2023. Janë mbajtur gjithsej 4 seanca, aq sa janë të përcaktuara sipas udhëzimit administrativ. Janë shqyrtuar 6 raporte të njësisë së auditimit të brendshëm për drejtori përkatëse dhe në sektorë të tjera në kuadër të zyrës së kryetarit. Vlen të theksohet se prej të gjitha raporteve janë dhënë rekomandimet e nevojshme për kryetarin e komunës dhe për drejtoritë. Komiteti i Auditimit e ka miratuar edhe planin strategjik të njësisë së auditimit të brendshëm për 2024-2026.

**Kryesuesi:** Faleminderit Mirsad Shala! Në qoftëse nuk kemi diskutime, atëherë, kalojmë në pikën tjetër.

#### **11. Shqyrtimi i informatës për menaxhimin e Aseteve Komunale;**

**Erhan Morina:** Faleminderit kryesues! Si çdo vit tjetër, Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm edhe kësaj radhe ka përgatitur një informatë për menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2023. Gjatë vitit 2023 janë formuar 4 komisione: Komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare, komisioni për inventarizim të pasurive jofinanciare, komisioni për tjetërsim të pasurive jofinanciare dhe komisioni për asgjësimin e pasurive jofinanciare. Të gjitha këto komisione të formuara, i kanë përfunduar punën me kohë duke filluar nga procesi i regjistrimit të aseteve, inventarizimi, si dhe gjatë vitit 2023 nuk ka pasur tjetërsim dhe asgjësim të aseteve komunale. 709 asete janë jashtë përdorimit, të cilat planifikojmë që gjatë vitit 2024 t'i shesim përmes ankandit publik. Gjatë vitit 2023 përmes ankandit publik janë shitur asete të papërdorura të komunës, duke përfshirë stufa të dëmtuara të shkollave, kalldaja, dritare të dëmtuara, karrika të dëmtuara dhe banka shkollore (të gjitha në vlerë 800€). Po ashtu, janë shitur edhe 4 vetura të cilat kanë qenë jashtë përdorimit në vlerë 4100€, si dhe një kamion me rimorkio në vlerë prej 8050€. Totali i të gjitha aseteve të shitura gjatë vitit 2023 ka qenë 12.950€.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Në qoftëse nuk kemi diskutime, kalojmë në pikën tjetër.

#### **12. Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! Të nderuar kuvendarë, para jush, sipas planit të kuvendit e keni informatën për menaxhimin të pronave komunale ndër vite. Pronat komunale janë rritur, kjo falë vendimit të Kryeministrit Haradinaj. Në atë kohë ai ka marrë vendim që t'i kthehen komunës 34 ha që kanë qenë në menaxhim të Agjencionit Pyjor. 7 ha në zonë kadastrale në Rahovec, si dhe vendimet tjera që vijnë prej gjyqësorit. Shumë shpejt do të kalojë edhe prona ku aktualisht është prona e benzinës. Sipas zonave, janë 34 zona dhe fatmirësisht në çdo zonë të komunës së Rahovecit ka pronë komunale. Mendimi juridik është që prona komunale edhe nëse ka padi, nuk tjetërsohet, nuk bartet dhe nuk prej mandatit të parë kemi asnjë lëndë të fituar nga ata që e kanë paditur komunën.

**Defrim Kafexhiu:** E kam vetëm një pyetje apo kërkes nga drejtori. Nëse ka mundësi që këtë listë të na përcjellësh me email zyrtar. T'i mësojmë sakt lokacionet dhe objektet e komunës.

**Kryesuesi:** Faleminderit Defrim Kafexhiu! Në qoftëse nuk kemi diskutime, kalojmë në pikën tjetër.

#### **13. Shqyrtimi i informatës rreth Programit për Banim për vitin 2023;**

**Saranda Sallteku:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Kjo informatë rrjedhë nga programi komunal 3 vjeçar për banim 2022-2025. Ky plan është aprovuar nga kuvendi i komunës së Rahovecit 28.10.2022. Periudha raportuese për këtë informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkundesjes Sociale është janar – dhjetor 2023. Kërkesa për banim social drejtuar drejtorisë sonë kanë qenë gjithsej 13. Pas verifikimit nga zyrtarët përgjegjës janë përzgjedhur 4 familje për t'i mbështetur me strehim të përkohshëm. Pakoja financiare e këtyre 4 familjeve është 600€ në muaj.

**Kryesuesi:** Faleminderit! A kemi ndonjë diskutim?... Nëse jo, atëherë, të nderuar anëtarë kemi arritur në pikën e fundit që ka të bëjë me pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

#### **14. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve – diskutimet e tyre;**

**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje edhe njëherë për të gjithë! Me votë të kuvendit kjo pikë kaloi si e fundit në rend dite. Unë përsëri kërkoj prej grupit të aleancës dhe ekzekutivit, që edhe nëse nuk ka nevojë të vendoset në votim, prej seancën tjetër me mirëkuptim kjo pikë të rikthehet si pikë e dytë e rendit të ditës. Kryetari thotë që ne po tregohemi pak xhentëlmen, këtu mund të tregoheni xhentëlmen duke e vendosur përsëri si të dytën me radhë. Në fund të seancave gjithmonë niveli i diskutimit është i ulët dhe vullneti gjithashtu. Deri në fund të seancave, dyshoj që as drejtorët nuk do të qëndrojnë në sallë. Mendimi im është ky, nëse dëshirojmë të vazhdojmë me politikë, atëherë këtë pikë mund ta hiqni krejt, kemi forma të tjera të komunikimit me qytetarë. Tregohuni pak më xhentëlmen, si pikë e dytë ka qenë më mirë, si dhe arsyeja për ta vendosur si të fundit në rend dite është absolutisht e paqëndrueshme.

**Kryetari:** Do të bisedoj me zë më të ulët, sepse sot jam munduar të jem më i kufizuar për shkak të përvjetorëve që i kemi. Për mua fare nuk është me rëndësi a bisedohet në fund apo në fillim, kuvendi është arenë e diskutimeve. Kuvendi i komunës sot ka vendosur ndryshe dhe ju siguroj që jam gati unë dhe ekipi im për çdo seancë. Zakonisht, asnjë vendim nuk duhet të miratohet pa u diskutuar, por, vendimmarrja është përtej pikës së diskutimeve dhe pyetjeve. Qytetarët e komunës, presin vendime nga kuvendi i komunës. Nuk do të doja t'i jap rëndësi më shumë pikës së diskutimeve, sesa vendimit për lokacionin e stadiumit, apo edhe të bartjes së mjeteve. Unë nuk e kam marrur këtë vendim, kuvendi e ka bërë me votë. Sa për mua, nëse dëshironi mbajmë edhe seanca të veçanta me vetëm një pikë të rendit të ditës. Mos harroni, debatit nuk i shmangna asnjëherë. Në pikën e diskutimeve ju siguroj që edhe unë edhe ekzekutivi me atë që dimë, do t'ju përgjigjemi gjithmonë sakt, korrekt dhe pa vonesa në përgjigje, sepse ka kryetar komuna që nuk përgjigjet hiq, as me pjesëmarrje në kuvend. Unë nuk i takoj asaj bote dhe atij koncepti. Mbledhja është një herë në muaj dhe nuk kemi punë më të rëndësishme sot se sa puna e kuvendit. Përndryshe, jam i hapur për kritika, por jo për gjuhë fyese, sepse ka plot argumente dhe fakte që mund ta bëjmë një arenë të debateve konstruktive. Xhentëmen duhet me qenë, për mua vendoseni përsëri në votim, le të rrin e dyta apo e treta, por keni vendosur ju dhe ju siguroj që unë nuk kam vendosur.

**Rasim Fazliu:** Faleminderit kryesues! E kam një kërkesë të qytetarëve të fshatit Celinë dhe të kryesisë së fshatit. Më kanë autorizuar t'ju pyes se kur do të bëhet vendosja e fotografive në varrezat e dëshmorëve në Celinë? Varrezat paraprahe që kanë qenë i kanë pasur fotografitë dhe është mirë të realizohet kjo dëshirë dhe kërkesë e tyre. Unë nuk jam i njoftuar me procedurat që kanë qënë më herët, por po e bëj si pyetje! Pyetja e dytë: Kryetar i nderuar, rruga Fortesë - Celinë është shumë e frekuentuar, sepse është rrugë e shkurtër dhe shumëkush ia mbanë "trup". Ka 2 apo 3 vite që po e diskutojmë këtu dhe po më vie keq që përsëri po e ngris të njëjtën çështje. Është mirë të merrni hapa konkret, sepse shumë gjatë shkoi kjo punë. Me këtë gjendje po bëhet dëmtimi i makinave dhe gjithashtu puna mund të vie edhe te aksidentet. Nuk po flas politikisht, por kjo është nevojë imediate që duhet të rregullohet brenda 3-4 dite.

**Kryetari:** Rasim, në kontratën e vjetër të ndërtimi të varrezave në Celinë nuk ka qenë i paraparë ndërrimi i fotografive sepse ka qenë pak problem në atë kohë. Në kontratën e re përsëri nuk janë të paraparë për shkak të ndjeshmërisë, por ne do t'i vendosim. E kemi lidhur kontratën e re dhe do t'i vendosim fotografitë. Rruga Fortesë – Celinë është rrugë e dëmtuar dhe po dëmtohet vazhdimisht. Sidoqoftë për ato grapa për të cilat po flet, e që po rriten përditë, ne kemi kontratë për riparime dhe me përmirësimin e kohës do t'i jap prioritet së paku rregullimit të atyre gropave.

**Vlora Vuçitërna:** Përshëndetje! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, drejtorë, media. Sot dua ta ngris një shqetësim të të gjithë banorëve që marrin shërbime në QKMF në Rahovec. Besoj që e dini për çka është fjala, sepse kam reaguuar edhe në rrjetet sociale si shteqësim. Drejtoria e Shëndetësisë para dy muajve ka marrë vendim që pediatria pas orës 14:00 të mos punojë. Këta pacienta ta "programojnë" sëmundjen e tyre që para orës 14:00, ose përndryshe, detyrohen që shërbimet t'i marrin në njësinë e mjekësisë familjare në Rahovec. E para, kërkojmë llogari pse ka ardhur deri te ky vendim, duke e ditur që ka pasur pediater në pediatri, zakonisht 2 pediater para dite, pasdite asnjë. Kjo gjë përsëri

ka qenë e mirë sepse fëmijët i kanë marrë shërbimet ndaras nga të rriturit. E dyta, këta fëmijë që po detyrohet t'i marrin shërbimet pas orës dy në njësinë e mjekësisë familjare. Kryetar, a e dini se fëmijët shërbimet i marrin në të njëjtën dhomë me pacienta tjerë, përkundër që ju e keni veçuar një dhomë, mirëpo ajo nuk funksionon! Kryetar, a e dini se fëmija shkon aty që të shërohet nga një virus, e del duke i marrë 100 viruse të tjera. A jeni në dijeni që i njëjti fëmijë po inhalohet me të njëjtin aparat të inhalimit me të rriturin. A jeni në dijeni që fëmija kur të shkon aty, e sheh një të rritur duke e pastruar një plagë, gjë që ndikon në psikikën e tij. A e dini që josecili ka mundësi që fëmijën ta dërgojë në privat dhe detyrohet që shërbimet t'i merr në njësinë e mjekësisë familjare. A e dini se shumica e stafit të mjekëve kanë qenë kundër këtij vendimi, sepse po krijohet tollovi e madhe. Përkundër kësaj, ju keni dalur përsëri me një vendim, i cili rrezikon shëndetin dhe nuk e shëron. Kërkoj përgjigje nga drejtoresha, si dhe në emër të pacientëve të Komunës së Rahovecit kërkoj që pediatria të kthehet ashtu siç ka qenë më herët, me dy orare.

**Saranda Sallteku:** Faleminderit Vlorë për pyetjen. Në QKMF asnjëherë nuk ka pasur pediatër në ndërrimin e dytë, prej orës 14:00 deri në 21:00, por punon mjeku i përgjithshëm familjar. Vendimet nuk i marrim ne. Është këshilli drejtues dhe drejtori i QKMF-së ai që i merr vendimet dhe i bën oraret. Sa i përket inhalimit, është dhomë e veçantë për fëmijë.

**Vlora Vuçitërna:** E ceka që paradite kanë qenë dy pediatër, pasdite asnjë dhe nuk e di pse nuk ka pasur. Do të ishte mirë të ndahen, një paradite, një pasdite. Mirëpo, përsëri kjo e ka pasur një të mirë sepse fëmijët shërbimet i kanë marrur të ndarë nga të rriturit. Tani, është shumë e vërtetë që shërbimet i marrin në të njëjtën dhomë me të rriturit dhe inhalohen bashkë me të rritur, kam fakte.

**Saranda Sallteku:** Vlora, në kujdesin primar shëndetësor pediatri nuk punon pas orës 14:00, është e rregulluar me ligj dhe nuk mund ta detyrojmë të punon. Aty është mjeku familjar i cili punon për të gjithë pacientët. E veçantë është dhoma për fëmijët, inhalimin gjithashtu e kanë të veçantë.

**Vlora Vuçitërna:** Se di a jam e qartë, apo jo? Nuk po kërkoj që pediatri të punojë pasdite, por, kërkoj që shërbimet t'i marrim përsëri në pediatri.

**Kryetari:** Faleminderit kryesues! Vlora i paraqiti disa shqetësime interesante dhe më bëri nder, sepse unë di shumë gjëra, por jo të gjitha. Të falënderoj për këto shqetësime! Unë e di që ne bëjmë vetëm politika shëndetësore në nivel lokal, me kapacitetet që i ka drejtorja dhe komuna. Ju e dini që e keni miratuar një statut këtu, ti gjithashtu e ke ngritur dorën për miratimin e statutit të QKMF-së. Megjithatë, shërbimet në rrjetin e QMF-ve dhe AMF-ve dita e ditës po përmirësohen dhe janë më cilësore, duke u rritur kënaqshmëria e pacientëve. A ka defekte organizative? Gjithësesi po! Të premtoj që në takimin e radhës, pyetjet e tua do t'ju bëj atyre dhe e shikoj nëse përgjigjet e Sarandës a ishin të sakta, si dhe shqetësimet e tua a ishin reale?

**Merisa Sharku:** Përshëndetje për të gjithë. Dua të flas për një problem që ka ndodhur në sheshin qëndror. Ka ndodhur rrëshqitja e pusëtës, pastaj ka rrjedhur uji dhe ka bërë dëme në hidroizolim të vendosur prej kompanisë që i kryen punimet aty. Këtë shqetësim e kam ngritur menjëherë në rrjetet sociale. Cila do të jetë zgjidhja e këtij problemi nga komuna dhe kompania? Duke e ditur rëndësinë e hidroizolimit dhe mos të vinë problemet tutje në parkingun e sheshit qëndror.

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit kryesues! Po, është e vërtetë që gjatë punimeve kemi pasur një rrëshqitje të pusëtës dhe vendi i punës në parking është mbushur me ujë. Betoni i varfër që ka qenë aty është dëmtuar. Sa i përket izolimit, për shkak të sigurisë nuk kemi mundur të qëndrojmë me atë izolim. Izolimi që është bërë, përkundër që nuk është i paraparë në kontratë, kompania e ka marrë përsipër duke përdorur aditiv në beton. Sa i përket pusëtës, gypi i kolektorit që është i qytetit kalon nëpër stadium dhe pa u zhvendosur stadiumi, nuk mund të ndërhyjmë në atë pjesë. Për moment jemi duke e mirëmbajtur dhe në moment që e bëjmë zhvendosjen e stadiumit, aty do të bëhet gypi i ri i kolektorit.

**Merisa Sharku:** Së pari, e kam të qartë që vendosja e asaj pusete ka qenë zgjidhje e përkohëshme. Por, zgjidhja e përkohëshme është dashur të jetë pak më e mirë, ashtu siç është tani. Kam qenë në vend të ngjarjes dhe e ka parë që është bërë një përforsim i mirë i gypit. Herën e parë nuk është paraparë që do të ketë presion të ujit dhe ajo pusete do

të bie. E dyta, nuk është aq e thjesht puna e hidroizolimit, këto gjëra duhet të parashihen tani dhe jo t'i lëmë që në të ardhmen aty të shfaqen probleme të ndryshme. Përderisa e keni vendosur tani aditivin, pse atëherë më herët kompania ka bërë shpenzime duke e vendosur hidroizolimin, përderisa nuk ka pasur nevojë.

**Albnor Mullabazi:** Nuk e thash që ka pasur nevojë, apo jo! Izolimi është bë. Është vendosur betoni i varfër, izolimi dhe përsori betoni i varfër. Gjatë përmbysjes me ujë, ngritje të betonit të varfër kemi pasur vetëm në një vend. Izolimi në atë pjesë nuk është dëmtuar, por për ta rritur sigurinë e kemi përdorur edhe aditivin. Sa i përket pusëtës, puseta ka qenë ekzistuese, por për shkak të gërmimit që ka ndodhur në atë anë, në anën tjetër gypi nuk e ka përballuar.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi pyetje dhe diskutime të tjera, e quaj të mbyllur mbledhje. Duke iu falënderuar për vëmendje, shihemi në mbledhjet e radhës.

**Procesmbajtësi:**

---

**Albion Krasniqi**

**K R Y E S U E S I**

---

**Arbër Zenuni**



**Drejtoria për Shërbime Publike**  
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge  
Department of Municipal Public Services

Datë/Datum/Date:	04.04.2024
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Rahovecit
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë

**Informatë mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit**

Komuna e Rahovecit ka kontraktuar 2 kompani për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonës dimërore dhe verore.

1. Periudha dimërore llogaritet nga data 15 nëntor deri me 15 mars të vitit që vie,
2. Periudha verore llogaritet nga 15 marsi i atij vitit deri me 15 nëntor.

Gjatë sezonës dimërore parashihen të mirëmbahen rrugët nga bora dhe akulli, si dhe hedhja e kripës industriale, ndërsa momentin që nuk ka borë kompanitë janë të detyruar të bëjnë pastrimin e rrugëve nga mbeturinat.

Ndërsa gjatë sezonës verore parashihen të mirëmbahen rrugët duke përfshirë larjen dhe pastrimin e brezave rrugore dhe trotuareve.

Sa i përket mirëmbajtjes dimërore të rrugëve komuna e Rahovecit e ka ndare në 2 lote mirëmbajtje të rrugëve urbane dhe atyre lokale;

**Lot-1, 258,501.48** euro, KRM Ekoregjioni, kontrata (02.02.20204) është 3 vjeqare

**Lot-2, 416,547.80** euro, Eko Drinia, kontrata (02.02.20204) është 3 vjeqare.

Ne vitin 2023, ky projekt ka qenë i ndare në 3 lote.

**KOMUNA RAHOVEC**

## **Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike**

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat tjera duke përfshirë, varreza civile, varreza të Dëshmoreve, lapidare, vegjetacione, breza rrugore apo trotuare, përveç kësaj duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur edhe këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikisht risi është edhe larja dhe lyerja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës së Rahovecit.

Ne specifikime teknike është kërkuar që edhe deponite ilegale të largohen, vetëm në muajin mars kemi bërë aksion të gjithmbarshme në komune për eliminimin e deponive ilegale.

Për më shumë detaje dhe sqarime tjera, do të jemi të hapur të diskutojmë gjatë mbledhjes së KPF-së dhe Mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtorja e Shërbimeve Publike

---

### **KOMUNA RAHOVEC**

Drejtorja për Shërbime Publike

Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë

Tel: +383 29 276 943

<http://kk.rks-gov.net/rahovec>



PRILL 2024

# KOMUNA E RAHOVECIT DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Raporti financiar Janar-Mars 2024

## Përmbajtja

<b>HYRJE .....</b>	<b>2</b>
<b>1. TË HYRAT VETANAKE .....</b>	<b>3</b>
1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2024-2023.....	3
1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2024/2023 dhe krahasimi i tyre.....	3
1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2018-2024. ....	3
1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2024/2023 .....	3
1.5 Përmbledhja e të hyrave të realizuara, të rregullta, gjobat e trafikut, gjobat nga gjykatat, të hyrat nga pyje 2024/2023 .....	4
1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2024/2023 .....	5
<b>2. TATIMI NË PRONË.....</b>	<b>6</b>
2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2024/2023 .....	6
2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë .....	6
<b>3. REALIZIMI I BUXHETIT .....</b>	<b>7</b>
3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë .....	7
3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike.....	8
3.3 Shpenzimet e klasifikuara brenda afatit kohorë 30 ditë dhe jashtë afatit kohorë 30 ditë. ....	9
3.4 Mallra dhe Shërbime sipas programeve.....	10
3.5 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike.....	13
3.6 Shërbime Komunale.....	15

## HYRJJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsim dhe Shkencë për periudhën Janar – Mars 2024 duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetanake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjocat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Mars të vitit 2024/2023

Buxheti i Komunës për vitin 2024, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2024, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
  - Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
  - Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,
  - Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.
- ❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:
- Realizimi i të hyrave vetjake-komunale sipas burimeve,
  - Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
  - Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

## 1. TË HYRAT VETANAKE

## 1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2024-2023

Përshkrimi	Realizimi 2023	Realizimi 2024	Ndryshimi 2024-2023	Krahasimi 2024/2023
Të hyrat e rregullta	358,958.61	378,122.54	19,163.93	5.34

**-Vërejtje:** në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2023 dhe 2024 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.

## 1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2024/2023 dhe krahasimi i tyre.

Periudha	Realizimi 2023	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Ndryshimi Realizimi/Planifikim 2024	Përqindja e Realizimit 2024
	1	2	3	3/2	3/2
Janar	102,903.74	120,408.66	108,957.89	(11,450.77)	(9.51)
Shkurt	98,383.47	120,408.66	84,560.42	(35,848.24)	(29.77)
Mars	157,671.40	120,408.66	184,604.23	64,195.57	53.31
<b>Totali</b>	<b>358,958.61</b>	<b>361,225.98</b>	<b>378,122.54</b>	<b>16,896.56</b>	<b>104.68</b>

## 1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2018-2024.

Periudha	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Janar	71,296.21	67,441.16	73,433.20	79,206.53	66,546.55	102,903.74	108,957.89
Shkurt	79,441.98	101,728.36	90,756.67	85,381.57	69,046.40	98,383.47	84,560.42
Mars	100,586.69	77,787.87	80,321.71	116,898.68	119,738.61	157,671.40	184,604.23
<b>Totali</b>	<b>251,324.88</b>	<b>246,957.39</b>	<b>244,511.58</b>	<b>281,486.78</b>	<b>255,331.56</b>	<b>358,958.61</b>	<b>378,122.54</b>

## 1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2024/2023

## Gjobat e gjykatës baza mujore

Muajt	Gjobat e gjykatave 2023	Gjobat e gjykatave 2024	Ndryshimi 2024-2023	% 2024/2023
Janar	2,483.33	-	(2,483.33)	(100.00)
Shkurt	1,761.00	-	(1,761.00)	(100.00)
Mars	3,300.00	-	(3,300.00)	(100.00)
<b>Totali</b>	<b>7,544.33</b>	<b>-</b>	<b>(7,544.33)</b>	<b>(300.00)</b>

## Gjobat në trafik në baza mujore


Muajt	Gjobat e trafikut 2023	Gjobat e trafikut 2024	Ndryshimi 2024-2023	% 2024/2023
Janar	18,680.00	-	(18,680.00)	(100.00)
Shkurt	19,310.00	-	(19,310.00)	(100.00)
Mars	24,695.00	-	(24,695.00)	(100.00)

1.5 Përmbledhja e të hyrave të realizuara, të rregullta, gjobat e trafikut, gjobat nga gjykatat, të hyrat nga pyje 2024/2023

**Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik, Të hyrat nga pyje 2024/2023**

Përshkrimi	Realizimi 2023	Realizimi 2024	Ndryshimi 2024-2023	Krahasimi në % 2024/2023
Të hyrat e rregullta	358,958.61	378,122.54	19,163.93	5.34
Gjobat e gjykatave	7,544.33	-	(7,544.33)	-100.00
Gjobat e trafikut	62,685.00	-	(62,685.00)	-100.00
Të hyrat nga pyje	-	-	-	#DIV/0!
<b>Totali</b>	<b>429,187.94</b>	<b>378,122.54</b>	<b>(51,065.40)</b>	<b>-11.90</b>

**Paraqitja Grafike të hyrat 2024/2023**



## 1.6 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2024/2023


Kodet	Përshkrimi	Planifikimi 2024	Realizimi 2023	Realizimi 2024	Ndryshimi 2024-2023	Krahasimi në % 2024/2023	Realizim/Planifikim 2024 në %
40110	Tatimi në pronë	431,715.00	202,858.46	225,539.57	22,681.11	11.18075628	52.24
40110	Tatimi ne Tokë	276,704.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50001	Taksa per Regjistrimin e Automjeteve	100,000.00	25,015.00	23,920.00	-1,095.00	-4.38	23.92
50002	Taksa rrugore		0.00	2,630.00	2,630.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	45,000.00	8,716.22	6,071.36	-2,644.86	-30.34	13.49
50010	Taksa për demolim	1,000.00	291.00	1,019.00	728.00	250.17	101.90
50011	Taksa regjistrimin e trashigimisë	32,000.00	8,590.00	8,125.00	-465.00	-5.41	25.39
50012	Taksa për ndrrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	1,000.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50013	Taksa për certifikatat e lindjes	14,000.00	559.00	368.00	-191.00	-34.17	2.63
50014	Taksa për certifikatat e kurorzimit	9,000.00	1,785.00	2,360.00	575.00	32.21	26.22
50015	Taksa për çertifikatat e vdekjes	2,000.00	368.00	399.00	31.00	8.42	19.95
50016	Taksa për çertifikatat e tjera të ofiqarisë	45,000.00	11,386.00	10,936.00	-450.00	-3.95	24.30
50017	Taksa per verifikimin e dokumenteve te ndryshme	8,000.00	1,458.00	6,430.00	4,972.00	341.02	80.38
50018	Taksa e fotokopjimit të dokumenteve		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50019	Taksa të tjera administrative	51,750.00	8,532.00	7,528.00	-1,004.00	-11.77	14.55
50020	Taksë për pjesëmarrje në tender	200.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50026	Takse për legalizimin e objekteve		0.00	551.00	551.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50029	Takse për ushtrimin e veprimtarisë	106,863.00	13,576.00	15,102.50	1,526.50	11.24	14.13
50032	Taksa për certifikata të Pronsisë	15,000.00	5,348.00	4,159.00	-1,189.00	-22.23	27.73
50045	Leje mjedisore komunale	10,000.00	3,686.84	898.64	-2,788.20	-75.63	8.99
50103	Largimi dhe deponimi i automjeteve	500.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50104	Gjodat nga inspektoriat	10,000.00	12,884.87	8,750.00	-4,134.87	-32.09	87.50
50201	Licencat për aktivitete individuale dhe të lira	500.00	276.00	170.00	-106.00	-38.41	34.00
50205	Licencat për pranim teknik të lokalit	1,000.00	570.00	375.00	-195.00	-34.21	37.50
50206	Licencat për shërbimet profesionale	50.00	2.00	11.00	9.00	450.00	22.00
50209	Licenca për korrje/fshirje		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50290	Licencat tjera për afarizëm	450.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50401	Shitja e shërbimeve	4,800.00	208.00	248.00	40.00	19.23	5.17
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	7,000.00	178.00	291.56	113.56	63.80	4.17
50406	Prona Publike për tregti të hapur		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50407	Qiraja për vendosjen e objektit tregtar	107,772.00	24,199.22	19,689.79	-4,509.43	-18.63	18.27
50407	Qiraja nga objektet e përkoshme (Sh.Publike)		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50408	Qiraja nga objektet publike	3,200.00	0.00	94.62	94.62	#DIV/0!	2.96
50408	Qiraja nga objektet publike (Bujqësia)		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50409	Participimet-Bujqësia	30,000.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50409	Participimet-Shëndëtesia	70,000.00	12,305.00	13,751.50	1,446.50	11.76	19.65
50409	Participimet-Qerdhja e Femijeve	30,200.00	9,990.00	11,730.00	1,740.00	17.42	38.84
50409	Participimet-Arsim		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50409	Participimet-Arsim jo formal		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50416	Të hyrat nga shitja e mbeturinave		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50503	Inspektimi rrespektimit të planit urbanistik	2,000.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
50504	Taks për matjen e tokës në teren	28,000.00	6,176.00	6,974.00	798.00	12.92	24.91
50507	Inspektimi higjenik sanitar		0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
	<b>Të hyrat pa gjodat</b>	<b>1,444,704.00</b>	<b>358,958.61</b>	<b>378,122.54</b>	<b>19,163.93</b>	<b>105.34</b>	<b>26.17</b>
	Gjodat e gjykatave	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
	Gjodat e trafikut	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
	Të hyrat nga pyje	200.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00
	<b>Totali</b>	<b>1,444,904.00</b>	<b>358,958.61</b>	<b>378,122.54</b>	<b>19,163.93</b>	<b>105.34</b>	<b>-73.83</b>

## 2. TATIMI NË PRONË

### 2.1 Planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë 2024/2023

Periodha	Të planifikuara	Të realizuara	Të planifikuara	Të realizuara	Përqindja e realizimit	Përqindja e realizimit	Krahasoni në %	Nr. çert të lëshuara	Nr.çert. të lëshuara	Nr faturave të paguara	Nr faturave të paguara
	2023	2023	2024	2024	2023	2024	2024/2023	2023	2024	2023	2024
Janar	65,876.17	102,903.74	59,034.91	57,988.27	156.21	-1.77	-43.65	831	177	2323	5251
Shkurt	65,876.17	98,383.47	59,034.91	35,143.73	149.35	-40.47	-64.28	639	148	1761	4431
Mars	65,876.17	157,671.40	59,034.91	132,407.57	239.35	124.29	-16.02	732	709	3920	15282
<b>Totali</b>	<b>197,628.51</b>	<b>358,958.61</b>	<b>177,104.73</b>	<b>225,539.57</b>	<b>181.63</b>	<b>127.35</b>	<b>(37.17)</b>	<b>2202</b>	<b>1034</b>	<b>8004</b>	<b>24964</b>

#### Paraqitja grafike 2024-2023



### 2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë

Viti	Numri i faturave të shpërndara	Vlera e faturuar	Numri objekteve të reja	Regjistrimet e reja m2	Numri objekteve të verifikuara	Verifikimi i objekteve m2
<b>2023</b>	12,506.00	1,190,441.96	65	12,152	22	2,583
<b>2024</b>		1,468,003.56	89	13,913	1148	191,725

**-Vërejtje:** në këtë tabelë të hyrat Numri i faturave të shpërndara mungon raporti nga Posta e Kosoves, sepse ajo është e kontraktuar për shpërndarjen e faturave.

## 3. REALIZIMI I BUXHETIT


## 3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë)

Programet (Drejtoritë)	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitalet	Totali i shpenzimeve
<b>Totali 10+21+22+31-99+04</b>	<b>3,074,605.27</b>	<b>782,364.82</b>	<b>83,692.62</b>	<b>116,229.32</b>	<b>1,728,649.65</b>	<b>5,785,541.68</b>
<b>HUAMARRJA 04</b>	-	-	-	-	-	-
Shendetësia	-	-	-	-	-	-
Arsim dhe Shkencë	-	-	-	-	-	-
<b>GRANDI QEVERTAR (10)</b>	<b>3,074,605.27</b>	<b>772,364.82</b>	<b>83,692.62</b>	<b>10,000.00</b>	<b>1,695,298.45</b>	<b>5,635,961.16</b>
Zyra e Kryetarit	44,209.49	12,999.77	-	-	-	57,209.26
Administrata	62,608.46	34,999.72	-	-	-	97,608.18
Çështje Gjinore	1,933.59	300.00	-	-	-	2,233.59
Inspekcioni	24,714.18	3,268.26	-	-	-	27,982.44
Zyra e Kuvendit Komunal	59,966.24	3,172.40	-	-	-	63,138.64
Buxhet dhe Financa	29,386.77	51,885.18	-	-	29,348.10	110,620.05
Shërbime Publike	10,016.00	145,096.02	50,000.00	-	339,999.16	545,111.18
Zjarrëfiksat	44,197.29	3,360.67	-	-	-	47,557.96
Zyra për Komunitete	22,814.04	2,705.39	-	-	-	25,519.43
Bujqësia	12,918.09	39,923.34	-	-	458,412.85	511,254.28
Zhvillimi Ekonomik	11,025.39	5,601.16	-	-	15,000.00	31,626.55
Kadastra dhe Gjeodezia	24,675.50	2,414.90	-	-	-	27,090.40
Urbanizmi	13,043.31	81,925.37	-	-	561,642.20	656,610.88
Shëndetësia	436,599.41	138,631.26	20,000.00	10,000.00	64,650.36	669,881.03
Shërbimet sociale	20,777.50	1,977.89	1,000.00	-	-	23,755.39
Kulturë, Rini dhe Sport	23,248.41	10,120.00	-	-	126,245.78	159,614.19
Administrata e arsimit	12,754.98	15,333.84	-	-	-	28,088.82
Arsimi Parafillor & Qerdhe	32,125.20	27,690.17	830.72	-	-	60,646.09
Arsimi Fillor	1,866,910.09	145,473.88	8,580.25	-	100,000.00	2,120,964.22
Arsimi i Mesëm	320,681.33	45,485.60	3,281.65	-	-	369,448.58
<b>TË HYRAT VETANAKE--21</b>	-	<b>10,000.00</b>	-	<b>106,229.32</b>	<b>33,351.20</b>	<b>149,580.52</b>
Zyra e Kryetarit	-	-	-	19,790.00	-	19,790.00
Administrata	-	-	-	-	-	-
Inspekcioni	-	-	-	-	-	-
Financa	-	-	-	-	-	-
Shërbime Publike	-	10,000.00	-	22,643.60	-	32,643.60
Zyra për Komunitete	-	-	-	-	-	-
Bujqësia	-	-	-	35,000.00	-	35,000.00
Zhvillimi Ekonomik	-	-	-	4,050.00	-	4,050.00
Kadastra dhe Gjeodezia	-	-	-	-	-	-
Urbanizmi	-	-	-	-	-	-
Shëndetësia	-	-	-	9,950.00	-	9,950.00
Kulturë, Rini dhe Sport	-	-	-	14,795.72	33,351.20	48,146.92
Arsim dhe Shkencë	-	-	-	-	-	-
<b>TE HYRAT E BARTURA-22</b>	-	-	-	-	-	-
Zyra e Kryetarit	-	-	-	-	-	-
Administrata	-	-	-	-	-	-
Shërbime Publike	-	-	-	-	-	-
Bujqësia	-	-	-	-	-	-
Zhvillimi Ekonomik	-	-	-	-	-	-
Shendetësia	-	-	-	-	-	-
Kultur, Rini dhe Sport	-	-	-	-	-	-
Arsim dhe Shkencë	-	-	-	-	-	-
<b>DONACIONE 31-99</b>	-	-	-	-	-	-
Zyra e Kryetarit	-	-	-	-	-	-
Shërbime Publike	-	-	-	-	-	-
Zik-ja	-	-	-	-	-	-
Zhvillimi Ekonomik	-	-	-	-	-	-
Shëndetësia	-	-	-	-	-	-
Arsim dhe Shkencë	-	-	-	-	-	-



Kategoritë Ekonomike	Buxheti sipas planifikimit	Alokimet SIMFK	Shpenzimet	Progresi ne % me planifikim	Progresi % me alokim
Pagat dhe mëditjet	10,407,314.00	3,088,549.54	3,074,605.27	29.54	99.55
Mallrat dhe Shërbimet	2,466,340.00	2,379,340.00	782,364.82	31.72	32.88
Shpenzimet komunale	390,000.00	390,000.00	83,692.62	21.46	21.46
Subvencionet dhe transferet	890,000.00	121,957.89	116,229.32	13.06	95.30
Shpenzimet kapitale	5,651,132.00	5,084,788.42	1,728,649.65	30.59	34.00
Rezerva	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Grandet	-	140,730.40	-	#DIV/0!	-
<b>GJITHSEJ</b>	<b>19,804,786.00</b>	<b>11,205,366.25</b>	<b>5,785,541.68</b>	<b>29.21</b>	<b>51.63</b>

### 3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike



## 3.3 Shpenzimet e klasifikuara brenda afatit kohorë 30 ditë dhe jashtë afatit kohorë 30 ditë.

Kategorite Ekonomike	Nr. i Pagesave	Pagesat brenda 30 dite	Pagesat jashtë 30 dite
Mallera dhe Sherbime	541	310	231
Shpenzime Komunale	136	133	3
Subvencione	41	11	30
Investime Kapitale	45	37	8
<b>Totali</b>	<b>763</b>	<b>491</b>	<b>272</b>

## 3.4 Mallra dhe Shërbime sipas programeve

Kodet	Përshkrimi	Zyra e Kryetarit		Administrata		Çështje Gjinore		Inspekcioni		Kuvendit Komunal		Buxhet dhe Financa		TOTALI	
		2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
	<b>Tabela A</b>														
13310	Shpenzimet për internet	44.00										102.00		146.00	-
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile		113.96									40.00		-	153.96
13330	Shpenzimet postare			34.44										34.44	-
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures	5,251.25	2,081.40					560.30						5,811.55	2,081.40
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures 21											15,177.50		-	15,177.50
13440	Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse		350.00				300.00							-	650.00
13345	Shërbimet e veqanta-Konsulentë dhe kontraktorë individual		1,416.24						708.12		650.00		1,416.24	-	4,190.60
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	596.39	169.58		344.82							51.44	31.25	647.83	545.65
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	2,170.30		1,494.59	1,409.00	100.00		1,050.43				15,984.08	4,754.58	20,799.40	6,163.58
13470	Shërbime Teknike												278.57	-	278.57
13475	Sigurimi fizik I objekteve publike				611.20									-	611.20
13480	Shpenzimet për Antarësim	5,431.20	3,000.00	9,000.00									5,000.00	14,431.20	8,000.00
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)						98.00					82.78		180.78	-
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)										1,967.59			1,967.59	-
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)				2,956.50									-	2,956.50
13610	Furnizime për zyrë	4,019.30	2,403.00	766.60	1,082.50						275.40	361.00	344.98	5,146.90	4,105.88
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)		63.50	118.00	194.90							184.60	63.00	302.60	321.40
13720	Nafte per ngrohje qendrore			11,444.30	5,343.15									11,444.30	5,343.15
13780	Karburant per vetura	1,327.74	1,584.14	514.90	224.85			839.77	898.13			385.28	882.96	3,067.69	3,590.08
13950	Regjistrimi i automjeteve	60.00						60.00				60.00		180.00	-
13951	Sigurimi i automjeteve	395.98	373.85	127.01				440.80	440.81			673.90	233.10	1,637.69	1,047.76
13953	Sigurimi i ndertesave tjera								611.20					-	611.20
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve		30.00		30.00				60.00				60.00	-	180.00
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	1,187.50	940.00	699.00	714.00			270.00	550.00		397.00	428.00	206.00	2,584.50	2,807.00
14020	Mirembajtja e ndertesave	243.14		10,593.94				30.44		7.48		74.36		10,949.36	-
14022	Mirembajtja e ndertesave administrative afariste				20,520.53								98.00	-	20,618.53
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve			167.00										167.00	-
14060	Mirembajtja rutinore											8,609.50	22,920.00	8,609.50	22,920.00
14220	Botimet e publikimeve	370.00								580.00				950.00	-
14230	Shpenzimet per informim publik										1,850.00			-	1,850.00
14310	Drekat zyrtare	745.00	474.10		1,568.27					420.00			379.00	1,165.00	2,421.37
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	153.40												153.40	-
	<b>Totali</b>	<b>21,995.20</b>	<b>12,999.77</b>	<b>34,959.78</b>	<b>34,999.72</b>	<b>198.00</b>	<b>300.00</b>	<b>3,251.74</b>	<b>3,268.26</b>	<b>2,975.07</b>	<b>3,172.40</b>	<b>26,996.94</b>	<b>51,885.18</b>	<b>90,376.73</b>	<b>106,625.33</b>

Kodet	Përshkrimi	Shërbime Publike		Zjarrëfikësat dhe Inspektimet		Zyra për Komunitete		Bujqësia		Ekonomia		Kadastri dhe Gjeodezia		TOTALI	
		2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
	<b>Tabela B</b>														
13310	Shpenzimet për internet			55.02		400.00		27.51				19.98		502.51	-
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile				110.49								19.98	-	130.47
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures											1,326.00		1,326.00	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse				450.00	900.00	2,245.00							900.00	2,695.00
13445	Shërbimet e veqanta-Konsulentë dhe kontraktorë individual								2,124.36		708.12		708.12	-	3,540.60
13450	Shërbime shtypje- jo marketing					692.78			12.74		25.17		21.27	692.78	59.18
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	3,663.68	1,000.00	367.89		766.53		5,394.52	36,179.96	1,777.45	3,691.28	1,493.81		13,463.88	40,871.24
13480	Shpenzimet për Antarësim		7,000.00											-	7,000.00
13490	Shërbimet e Varrimit	13,800.00												13,800.00	-
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)							97.00				95.00		192.00	-
13610	Furnizime për zyrë		64.00					822.22			98.00	200.80	962.10	1,023.02	1,124.10
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)							47.60	217.94					47.60	217.94
13760	Dru			1,676.00				3,900.00						5,576.00	-
13780	Karburant për vetura	86.35	241.28	1,152.62	999.95	229.73	339.39	323.49	274.53	203.29	198.99	318.59	299.41	2,314.07	2,353.55
13950	Regjistrimi i automjeteve	60.00	75.00	60.00	85.00			30.00		135.00	75.00	30.00		315.00	235.00
13951	Sigurimi i automjeteve	313.79	440.81	732.69	795.23			313.79	440.81	268.96		127.01	127.02	1,756.24	1,803.87
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve		60.00		160.00				30.00				30.00	-	280.00
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	100.00	345.00	30.01	760.00		121.00	2,750.00	548.00	591.00		237.00	149.00	3,708.01	1,923.00
14020	Mirembajtja e ndërtesave	403.90						478.10	95.00	1,708.20		120.47	98.00	2,710.67	193.00
14022	Mirembajtja e ndërtesave administrative afariste										804.60			-	804.60
14022	Mirembajtja e ndërtesave administrative afariste----21		10,000.00											-	10,000.00
14032	Mirembajtja e auto rrugëve lokale	101,059.37	91,832.88											101,059.37	91,832.88
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve			2,309.30				99.00		194.00				2,602.30	-
14060	Mirembajtja rutinore	20,235.47	43,962.95											20,235.47	43,962.95
14310	Drekat zyrtare		74.10											-	74.10
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave									112.10				112.10	-
	<b>Totali</b>	<b>139,722.56</b>	<b>155,096.02</b>	<b>6,383.53</b>	<b>3,360.67</b>	<b>2,989.04</b>	<b>2,705.39</b>	<b>14,283.23</b>	<b>39,923.34</b>	<b>4,990.00</b>	<b>5,601.16</b>	<b>3,968.66</b>	<b>2,414.90</b>	<b>172,337.02</b>	<b>209,101.48</b>


Kodet	Përshkrimi	Urbanizmi		Shëndetësia dhe Mirëqenja sociale		Qendra për punë sociale		Kulturë,Rini dhe Sport		Arsimi		Totali	
		2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
	<b>Tabela C</b>												
13130	Shpenzimet e Udhetimit zyrtar brenda vendit										8,570.13	-	8,570.13
13133	Shpenzimet tjera te udhitimit zyrtar brenda vendit									13,200.00		13,200.00	-
13310	Shpenzimet për internet									838.94	307.63	838.94	307.63
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile								260.08			-	260.08
13330	Shpenzimet postare			1.00				130.40				131.40	-
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures	4,290.00										4,290.00	-
13430	Shërbime te ndryshme shendetësore			9,767.15	60.00							9,767.15	60.00
13440	Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse					420.00			1,416.24		200.00	420.00	1,616.24
13450	Shërbime shtypje- jo marketing		40.26						6.70			-	46.96
13450	Shërbime shtypje- jo marketing- 21											-	-
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	36,300.00	64,784.54					2,478.42	72.00	9,230.56	1,380.00	48,008.98	66,236.54
13470	Shërbime Teknike		109.74						800.00			-	909.74
13490	Sherbimet e Varrimit			6,000.00								6,000.00	-
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)					7.22				168.00		175.22	-
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)		10,010.00									-	10,010.00
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)				19,624.75			2,365.75		1,040.00		3,405.75	19,624.75
13610	Furnizime për zyrë	292.17	2,074.50	1,214.25	19,675.25	82.40	494.38	4,829.00	1,472.90	5,921.37	5,901.85	12,339.19	29,618.88
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)			531.20	237.60			83.50		3,658.31	3,881.41	4,273.01	4,119.01
13630	Furnizime mjekësore			26,787.62	10,646.33							26,787.62	10,646.33
13640	Furnizime pastrimi			231.80	141.00			100.79		393.40	99.00	725.99	240.00
13650	Furnizim me veshmbathje			99.00								99.00	-
13720	Naftë per ngrohje qendrore			3,719.55	7,598.60		633.50			1,466.16		5,185.71	8,232.10
13760	Dru			11,426.00	17,968.00			3,900.00	1,950.00	3,196.62	212,127.10	18,522.62	232,045.10
13770	Derivate per gjenerator									195.12		195.12	-
13780	Karburant per vetura	170.76	245.51	10,946.71	12,428.74	291.83	652.01	154.68	297.54	244.59	295.45	11,808.57	13,919.25
13950	Regjistrimi i automjeteve	30.00		390.00	225.00	30.00	75.00	130.00				580.00	300.00
13951	Sigurimi i automjeteve	735.46	127.02	2,143.03	268.96	233.10					127.02	3,111.59	523.00
13953	Sigurimi i ndertesave tjera				2,750.40							-	2,750.40
13954	Kontrollimi teknik I automjeteve		30.00								30.00	-	60.00
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	107.00	312.00	6,782.00	4,619.40	397.00	123.00	642.50	67.50			7,928.50	5,121.90
14020	Mirembajtja e ndertesave	14.48						4,741.06	1,038.14			4,755.54	1,038.14
14022	Mirembajtja e ndertesave administrative afariste		4,090.00									-	4,090.00
14023	Mirembajtja e shkollave									4,955.37	964.90	4,955.37	964.90
14023	Mirembajtja e shkollave 21											-	-
14024	Mirembajtja e objekteve shendetesore			10,499.54	23,961.95							10,499.54	23,961.95
14027	Mirëmbajtja e objekteve kulturore								2,087.00				2,087.00
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative										99.00	-	99.00
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve			11,346.00	8,317.00							11,346.00	8,317.00
14060	Mirembajtja rutinore	5,000.00										5,000.00	-
14310	Drekat zyrtare	277.70	101.80						651.90			277.70	753.70
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave				10,108.28							-	10,108.28
	<b>Totali</b>	<b>47,217.57</b>	<b>81,925.37</b>	<b>101,884.85</b>	<b>138,631.26</b>	<b>1,461.55</b>	<b>1,977.89</b>	<b>19,556.10</b>	<b>10,120.00</b>	<b>44,508.44</b>	<b>233,983.49</b>	<b>214,628.51</b>	<b>466,638.01</b>
	Tabela A+B+C											477,342.26	782,364.82

## 3.5 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike

Kode t	Përshkrimi	2023	2024	Diferenca	Krahasimi ne %
13130	Shpenzimet e Udhetimit zyrtar brenda vendit	0.00	8,570.13	8,570.13	#DIV/0!
13133	Shpenzimet tjera te udhitimit zyrtar brenda vendit	13,200.00	0.00	-13,200.00	-100.00
13310	Shpenzimet për internet	1,487.45	307.63	-1,179.82	-79.32
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	0.00	544.51	544.51	#DIV/0!
13330	Shpenzimet postare	165.84	0.00	-165.84	-100.00
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures	11,427.55	2,081.40	-9,346.15	-81.79
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures 21	0.00	15,177.50	15,177.50	#DIV/0!
13430	Shërbime te ndryshme shendetësore	9,767.15	60.00	-9,707.15	-99.39
13440	Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	1,320.00	4,961.24	3,641.24	275.85
13445	Shërbimet e veqanta-Konsulentë dhe kontraktorë individual	0.00	7,731.20	7,731.20	#DIV/0!
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	1,340.61	651.79	-688.82	-51.38
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	82,272.26	113,271.36	30,999.10	37.68
13470	Shërbime Teknike	0.00	1,188.31	1,188.31	#DIV/0!
13475	Sigurimi fizik i objekteve publike	0.00	611.20	611.20	#DIV/0!
13480	Shpenzimet për Antarësim	14,431.20	15,000.00	568.80	3.94
13490	Shërbimet e Varrimit	19,800.00	0.00	-19,800.00	-100.00
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	548.00	0.00	-548.00	-100.00
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	1,967.59	0.00	-1,967.59	-100.00
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	0.00	2,956.50	2,956.50	#DIV/0!
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)	0.00	10,010.00	10,010.00	#DIV/0!
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	3,405.75	19,624.75	16,219.00	476.22
13610	Furnizime për zyrë	18,509.11	34,848.86	16,339.75	88.28
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	4,623.21	4,658.35	35.14	0.76
13630	Furnizime mjekësore	26,787.62	10,646.33	-16,141.29	-60.26
13640	Furnizime pastrimi	725.99	240.00	-485.99	-66.94
13650	Furnizim me veshmbathje	99.00	0.00	-99.00	-100.00
13720	Naftë per ngrohje qendrore	16,630.01	13,575.25	-3,054.76	-18.37
13760	Dru	24,098.62	232,045.10	207,946.48	862.90
13770	Derivate per gjenerator	195.12	0.00	-195.12	-100.00
13780	Karburant per vetura	17,190.33	19,862.88	2,672.55	15.55
13950	Regjistrimi i automjeteve	1,075.00	535.00	-540.00	-50.23
13951	Sigurimi i automjeteve	6,505.52	3,374.63	-3,130.89	-48.13
13953	Sigurimi i ndertesave tjera	0.00	3,361.60	3,361.60	#DIV/0!
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	0.00	520.00	520.00	#DIV/0!
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	14,221.01	9,851.90	-4,369.11	-30.72
14020	Mirembajtja e ndertesave	18,415.57	1,231.14	-17,184.43	-93.31

14022	Mirembajtja e ndertesave administrative afariste	0.00	25,513.13	25,513.13	#DIV/0!
14022	Mirembajtja e ndertesave administrative afariste---21	0.00	10,000.00	10,000.00	#DIV/0!
14023	Mirembajtja e shkollave	4,955.37	964.90	-3,990.47	-80.53
14024	Mirembajtja e objekteve shendetesore	10,499.54	23,961.95	13,462.41	128.22
14027	Mirëmbajtja e objekteve kulturore	0.00	2,087.00	2,087.00	#DIV/0!
14032	Mirembajtja e auto rrugeve lokale	101,059.37	91,832.88	-9,226.49	-9.13
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	0.00	99.00	99.00	#DIV/0!
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve	14,115.30	8,317.00	-5,798.30	-41.08
14060	Mirembajtja rutinore	33,844.97	66,882.95	33,037.98	97.62
14220	Botimet e publikimeve	950.00	0.00	-950.00	-100.00
14230	Shpenzimet per informim publik	0.00	1,850.00	1,850.00	#DIV/0!
14310	Drekat zyrtare	1,442.70	3,249.17	1,806.47	125.21
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	265.50	10,108.28	9,842.78	3,707.26
	<b>Totali</b>	<b>477,342.26</b>	<b>782,364.82</b>	<b>305,022.56</b>	<b>63.90</b>

Paraqitja grafike e raporti për Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike Janar-Mars 2024/2023 dhe krahasimi i tyre në përqindje.



## 3.6 Shërbime Komunale

Programet (drejtoritë)	Rryma (13210)		Uji (13220)		Mbeturinat (13230)		Telefon Internet 13250		Totali	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Shërbime Publike	66,802.69	48,083.87	898.78	1,460.65	<b>2260.59</b>	<b>455.48</b>			69,962.06	50,000.00
Shëndetësia	22,436.79	18,624.54	3,696.93	1,073.67	3,750.43	128.00	115.85	173.79	30,000.00	20,000.00
Qendra per pune Sociale	527.40	426.06		339.67			136.30	234.27	663.70	1,000.00
Arsim dhe Shkencë	7,701.13	7,565.03	5,416.09	3,288.44	2,083.23	1,510.42	277.71	328.73	15,478.16	12,692.62
<b>Totali</b>	<b>97,468.01</b>	<b>74,699.50</b>	<b>10,011.80</b>	<b>6,162.43</b>	<b>8,094.25</b>	<b>2,093.90</b>	<b>529.86</b>	<b>736.79</b>	<b>116,103.92</b>	<b>83,692.62</b>

Drejtoria për Buxhet dhe Financa : \_\_\_\_\_





Në mbështetje të nenit 12 të paragrafit 1 dhe 2 të shkronjës (d), nenit 17 të shkronjës (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019*), nenit 17 të paragrafit 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 të paragrafit 2 të pikës 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të paragrafit 1 të pikës 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### **Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 (katërdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01. Nr. 217/24 i datës 29.04.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510069-01505-0.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
  - 2.1. **Besmire Bytyqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
  - 2.2. **Berat Duraku**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
  - 2.3. **Sinan Kryeziu**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - AAK;
  - 2.4. **Ilir Pallqa**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës- LVV;
  - 2.5. **Adnan Rexha**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë deri në katërdhjetë (40) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj..
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.

6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr.218/24**  
**Datë:29.04.2024**

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



Në mbështetje të nenit 12 të paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008*), nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 17 të paragrafit 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 të paragrafit 2 të pikës 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të paragrafit 1 të pikës 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024, merr:

**V E N D I M**

**Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01. Nr. 214/24 i datës 29.04.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510057-01643-1.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
  - 2.1. **Erhan Morina**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
  - 2.2. **Besmire Bytyqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
  - 2.3. **Armir Vuçitërna**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës – PDK;
  - 2.4. **Valmir Gashi**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës- AAK;
  - 2.5. **Adnan Rexha**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesëmbëdhjetë (15) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr.214/24**  
**Datë:29.04.2024**

**Arbër Zenuni**

---

**Kryesues i Kuvendit**



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja (h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit me Nr. Reference 04/1659 të dt. 05.03.2024, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.04.2024 miraton këtë:

## V E N D I M

### **Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP)**

- Caktohet** komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP) në Komunën e Rahovecit që kanë konkuruar në konkurset e shpallura nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje:
  - 1.1.** Lulzim Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, pranë Drejtorisë për Arsim, kryesues
  - 1.2.** Vjollca Vuçitërna, Drejtoreshë në IAAP “Selajdin Mullabazi – Mici” në Rahovec, anëtare
  - 1.3.** Anëtar i tretë vjen nga MASH-i sipas UA Nr. 151/2020 i dt. 22.12.2020
- Detyra e komisionit është intervistimi i kandidatëve që kanë konkuruar në konkurset e cekura në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë Kryetarit të Komunës emërim të kandidatëve më të suksesshëm për drejtor/eshë apo zëvendës drejtor/eshë e shkollës sipas konkursit.
- Obbligohet komisioni përzgjedhës që punët të kryej duke u bazuar në liget dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Mandati i komisionit përzgjedhës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 1 (një) vit.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### **Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit,**
- Shërbimit të Kuvendit,**
- Drejtorisë për Arsim,**
- MAPL-së, dhe**
- Arkivit.**

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**



Në mbështetje të nenit 12 të paragrafit 2 të shkronjës (d), nenit 17 të shkronjës (a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008*), nenit 5, nenit 6 të paragrafit 1 të pikës 1.2, nenit 8 të paragrafit 1 të pikës 1.2 dhe nenit 14 të paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019*), nenit 5 të paragrafit 1 të pikës 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 të paragrafit 1 dhe 2 të pikës 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024 merr:

**V E N D I M**  
**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë**

1. **Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës Nr. 02/4078/24 i datës 12.04.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimi i procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 (katërdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën **1** të këtij vendimi është në zonën kadastrale Retijë, në vendin e quajtur “Suteska”, me kulturë Kullosë e klasës 5, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510069-01505-0, në sipërfaqe prej 279608m<sup>2</sup> (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është afatgjatë në periudhën prej 40 (katërdhjetë) vite.
5. Realizimi i pagesës në qira fillon pas 36 muajve.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01. Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.217/24**  
**Me datë:29.04.2024**

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, lidhur me nenin 24 dhe nenin 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024 merr këtë:

## V E N D I M

### Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për rastet e veçanta

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/4045/24 i datës 04.04.2024 dhe merret vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës – hapësirën në objektin e vjetër të QKMF-së “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec në shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim – hapësira në objektin e QKMF-së “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, e cekur në pikën 1 të këtij propozimi është në katin përdhësë të objektit të vjetër të QKMF-së “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec, duke përfshirë edhe infrastrukturën përcjellëse të inventarit medicinal dhe jomedicinal dhe aparaturave të Hemodializës.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është funksionalizimi i Hemodializës në objektin e QKMF-së “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
5. Prona e paluajtshme sipas pikës 1 dhe 2 të këtij propozimi i ipet Ministrisë së Shëndetësisë pa kompensim.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kurdo herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshojë kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.



8. Autorizohet Kryetari i Komunës që të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë evidentimin në librat kadastral të komunës, pronën e paluajtshme të dhënë në shfrytëzim për rastet e veçanta sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, u realizua duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019*”) dhe nenin 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.215/24**  
**Me datë:29.04.2024**

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (a) dhe nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008*), nenit 5, nenit 6 të paragrafit 1 të pikës 1.1 dhe nenit 8 të paragrafit 1 të pikës 1.1 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 të paragrafit 1 të pikës 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 të paragrafit 1 dhe 2 të pikës 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024 merr:

## V E N D I M

### Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës nr. 02/4046/24 i datës 04.04.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim të personave fizik, juridik dhe zhvillimi i procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën **1** të këtij vendimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur “Padina”, me kulturë Kullosë e klasës 3, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-01643-1, në sipërfaqe prej 73m<sup>2</sup> (shtatëdhjetë e tre metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7064m<sup>2</sup> (shtatë mijë e gjashtëdhjetë e katër metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej pesëmbëdhjetë (15) vite.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01 Nr.213/24**  
**Me datë:29.04.2024**

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40, nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 10, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 2.4, nenit 34 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, konform vendimit të Kuvendit të Komunës në Rahovec 01.Nr. 325/22, i datës 31.05.2022, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### Për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim

1. Me këtë vendim, caktohet përbërja dhe organizimi i Komitetit për Arsim në Komunën e Rahovecit.
2. Komiteti i caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, ku shumica e anëtarëve përbëhet nga anëtarët e Kuvendit, si dhe duhet të reflektojë përbërjen e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit jashtë kuvendit të Komunës, që janë ekspertë të fushës përkatëse.
3. Komiteti për Arsim në Komunën e Rahovecit, ka këtë përbërje:
  - 3.1. **Alban Bajraktari** - përfaqësues i Kuvendit nga radhët e AAK-së;
  - 3.2. **Ilir Pallqa** - përfaqësues i Kuvendit nga radhët e VV-së;
  - 3.3. **Fahrije Lushi Morina** - përfaqësues i Kuvendit nga radhët e LDK-së;
  - 3.4. **Sejfullah Sejfullahu** - përfaqësues i Kuvendit nga radhët e PDK-së;
  - 3.5. **Xhevdet Morina** - ekspert i jashtëm.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Arsim janë të përcaktuara në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në Komunë.
5. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Arsim është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01, Nr. 325/22, i datës 31.05.2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin me Nr. Prot. 01 Nr. 195/24, i datës 29.2.2024.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.220/24**  
**Me datë:29.04.2024**

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Në mbështetje të nenit 12 të pikës 1 dhe pikës 2 të shkronjës (d), nenit 14 të pikës 1, nenit 17 të shkronjës (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*), nenit 2, nenit 10 të paragrafit 2 të pikës 2.4, nenit 40, nenit 57 të paragrafit 1 të pikës 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.04.2024 miraton këtë:

### V E N D I M

#### **Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-71510057-01469-4 në Zonën Kadastrale Rahovec**

- Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës me nr. prot. 02/4048/24, i datës 05.04.2024 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për pjesën e parcelës **P-71510057-01469-4** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 220m<sup>2</sup> (dyqind e njëzetë metra katror) në vendin e quajtur “Podinë”, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Hajrullaga (Hilmi) Shpata.
- Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë “Zgjerimi i rrugës faktike në terren”.
- Autorizohet kryetari i Komunës që në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të Komunës.

#### **Vendimi u dërgohet:**

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

### **K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01Nr.216/24**  
**Datë: 29.04.2024**

**Arbër Zenuni**

**Kryesues i Kuvendit**



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 pika r) dhe s) dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 8, paragrafi 2 dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/2024”), nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.18 dhe 1.19, të Statutit të Komunës, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2024, miraton këtë:

### V E N D I M

#### **Për themelimin e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/4044/24, i datës 04.04.2024 dhe merret vendimi për themelimin e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe.
2. Muzeu i Masakrës së Krushës së Madhe do të jetë institucion kulturor lokal, i cili do të bëjë arkivimin, selektimin, ruajtjen dhe promovimin e dokumenteve dhe të gjëseneve të tjera të trashëgimisë së luajtshme me peshë historike individuale dhe shoqërore të Masakrës në Krushë të Madhe, të datës 26 mars 1999.
3. Qëllimi i themelimit të Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe është: mbledhja, sistemimi, ruajtja dhe ekspozimi i artefakteve, dokumenteve e gjëseneve të të vrarëve dhe të të zhdukurve me dhunë nga forcat shtetërore serbe në Krushë të Madhe. Muzeu ka për qëllim dokumentimin e krimeve serbe në marsin e vitit 1999, respektivisht paraqitjen e fushatës së vrasjeve, djegieve, shkatërrimeve e spastrimit etnik të kësaj zone, të kryera në datat: 25-26-27 mars 1999, si dhe paraqitja reale e krimeve të bëra nga forcat serbe, duke përfshirë vendet e ekzekutimeve në grupe të njerëzve, djegien e kufomave (krematoriumet), si dhe prezantimin e dhunës sistematike serbe ndaj banorëve të kësaj ane. Muzeu ka vlerë kulturore e historike dhe është i ndarë në kënde ku do të ekspozohen dëshmi e artefakte të ndryshme, që pasqyrojnë fragmente të jetës së personave të vrarë, të grave, të fëmijëve, të mësuesve e të njerëzve të paarmatosur, këndin e dëshmorëve dhe dëshmi materiale e shpirtërore të atyre që u zhdukën me dhunë në Krushë të Madhe.
4. Muzeu, në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë, të detyrave dhe të kompetencave të tij, do të organizojë njësitë përkatëse organizative me punonjës të kualifikuar, të cilët do të përgatisin statutin dhe aktet e tjera normative, të cilat do të dërgohen për miratim në Kuvendin e Komunës.
5. Selia e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe, do të jetë në fshatin Krushë e Madhe-Komuna e Rahovecit, respektivisht në Parcelën Kadastrale Nr. P-71513005-00465-0.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr.221/24**  
**Datë:29.04.2024**

**Arbër Zenuni**  

---

**Kryesues i Kuvendit**